

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

23.03.2021  
Ora 10:06

**RENDI I DITËS**

**Projektakti "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.5, "Kundërshtim i vendimit nr.156, dt.17.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve", subjekti ankues PD-AN".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD, PS

**Z. E. Lako:** Atëherë, mirëmëngjes të gjithëve! Deklarojmë të çelur seancën e sotme për shqyrtim në themel të ankimit numër 5, të subjektit ankues "Koalicioni, Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", me objekt "Kundërshtimin e vendimit numër 156, datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve". Relatori i kësaj çështjeje jam zgjedhur unë Ervin Lako, sipas shortit të hedhur në datën 19 Mars të vitit 2021. Përpara së të filloj me shqyrtimin e çështjes, bëjmë verifikimin procedural të paleve në proces. Është i pranishëm, ankuesi i subjektit zgjedhor "Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim" përfaqësuar nga zoti Ivi Kaso.

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Prezent!

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. E. Lako:** Faleminderit! Është administrata e KQZ, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Meqë jemi ketu, a ka ndonjë kërkesë për të marrë pjesë si palë e interesuar, ndonjë subjekt?

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Kam depozituar në sekretari, kërkesë për t'u regjistruar si person i interesuar Partia Socialiste.

**Z. E. Lako:** Mund të na e lexoni kërkesën?

**Z. Y. Merhaj:** Në datën 23.03.2021, nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste është bërë kërkesë për t'u futur si person i interesuar në çështjen administrative që shqyrtohet sot kërkesë ankimore numër 5.

**Z. E. Lako:** Po, atëherë në mbështetje të nenit 133 të Kodit Zgjedhor, KAS-i do të marrë vendim për pranimin apo jo të palës së interesuar në proces.

**Z.I. Rusmali:** (Pa mikrofon...)

**Z. E. Lako:** Arsyet, legjitimimin. Kërkesa është bërë pa arsye, vetëm....

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Mund t'a lexoj vetë.

**Z. E. Lako:** Po, patjetër.

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Përsa i përket, së pari do të thosha në parim, përsa i përket legjitimitit, si në këtë kërkesë mund të jenë dhe kërkesa të tjera. Ne

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

jemi subjekt zgjedhor, dhe për çdo vendimmarrje në të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, merr në lidhje me zgjedhjet, ne jemi direkt person i cili kemi të drejta dhe detyrime ndaj procesit, dhe çënohemi ose mund të fitojmë të drejta. Përsa i përket rastit konkret, subjekti zgjedhor Partia Socialiste ka ardhur në dijeni për kërkesën ankimore që ka depozituar Aleanca për Ndryshim kundër vendimit 156, datë 17.03, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Koalicioni zgjedhor në fjalë, është koalicion opozitar dhe për mbajtjen e zgjedhjeve të datës 25-së. Subjekti zgjedhor Partia Socialiste ka depozituar lista shumemërore dhe standarti në të cilën është mbajtur, është marrë një vendim për pranimin e listave, si dhe gjatë shqyrtimit administrativ që është shqyrtuar vendimmarrja e Komisionerit ne kemi qenë në proces, e kemi kundërshtuar listën e paraqitur nga Partia Demokratike, dhe Komisioneri ka vendosur në lidhje, jo me pretendimin tonë që ajo listë nuk duhet të pranohet në mënyrën si është paraqitur. Pra ne kemi qenë në shqyrtim administrativ që në procesin e vendimmarrjes dhe rrjedhimisht ne jemi dhe këtu dhe pa kërkesë, pra po të dali nga procesverbali del debati i palëve në shqyrtimin administrativ për miratimin e aktit.


**Z. E. Lako:** Faleminderit!

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Pra kemi qenë në proces. Ky është proces në vazhdim tani. Tani ju çmoheni, gjykoheni.

**Z.I. Rusmali:** Gjykoheni vetë, unë... Kjo do të bëhet në seancë, apo do të mblidhemi veçantë?

**Z. E. Lako:** Si të doni... (Pa mikrofon)

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z.I. Rusmali:** Pra e doni në seancë, në rregull.Nga analiza që i bëj unë dispozitës, mua më rezulton se procesi i regjistrimit të kandidatëve lidh subjektin që propozon listën e kandidatëve me institucionin që mbikqyr procesin. Lista e kandidatëve është vullnet sovran i subjektit që e prezanton atë dhe i kandidatëve që pranojnë të marrin pjesë, dhe nuk është vullnet as i KQZ-së. KQZ vetëm kontrollon verifikimin ose jo të kushteve dhe kriterëve që ka vendosur ligji për listën. Subjektet e tjera zgjedhore kanë interesa të ligjshme në raport me zgjedhjet padiskutim, por unë nuk shoh interesin e ligjshëm tek lista e kandidatëve. Regjistrimi i listës është vullnet i subjektit, i cili ka përveç vullnetit dhe detyrimin për të plotësuar kriteret ligjore. Subjektet e tjera që të jenë të interesuar dhe të kenë interes të ligjshëm për listën e një subjekti tjetër, mua më duket se ne e zgjerojmë shumë rrethin dhe e zgjerojmë në mënyrë të padrejtë. Nuk e kam hallin tek ky rast, por e kam hallin në tërësi tek legjitimimi i palëve të interesuara. Se me logjikën, kjo bëhet për zgjedhje dhe për zgjedhjet jemi të gjithë, nuk do të nxinte salla aq shumë palë të interesuara do të ishin. Kështu që nga ana tjetër unë mendoj që fakti që subjekti, Partia Socialiste ka marrë pjesë në shqyrtimin nga Komisioneri të çështjes nuk e detyron KAS-in që t'a konsiderojë këtë si shkak të mjaftueshëm për legjitimim. Kështu që unë do të thoja që mos ta konsideronim kërkesën.

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Një parashtrim tjetër, mundet ?

**Z. E. Lako:** Po.

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Tani, Kodi Zgjedhor thotë “KQZ regjistron listat”, KQZ ka regjistru listat që nga viti 2003 e në vazhdim. Kjo praktikë që ndiqet sot, lista është kundërshtuar dhe në vitet në vazhdim. Po të hapni praktikën e


*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, palët në diskutim si Partia Demokratike dhe Partia Socialiste kanë pasur sipas rasteve të veçanta ankime ndaj listës dhe pjesëmarrjes së subjekteve në listë. Pra ky lloj procesi administrativ është zhvilluar me dhjetra herë pranë komisionit. Praktika e komisionit ka qenë që palët e interesuara, siç është rasti që ne paraqesim, kur paraqesin interes të ligjshëm, janë pranuar nga KQZ. Dhe në këtë rast, pavarësisht se ju jeni një trupë tjetër, por praktika që ka ndjek ky institucion së pari. Së dyti, interesi është mjaft i ligjshëm se ka të bëjë me pabarazinë e palëve. Tani se me marrjen e këtij vendimi paragjykohet vendimmarrja e themelit. Se në qoftë se do të përjashtohet subjekti zgjedhor Partia Socialiste nga shqyrtimi i këtij akti administrativ, atëherë ju në vendimmarrjen tuaj keni paragjykuar vendimin. Se këtu në thelb është barazia e palëve. Ka dalë një akt, janë miratuar listat. Tani na vjen një listë me dyfishin e kandidatëve, domethënë prish garën. Nuk ka arsye me të qenësishme se mund të çenohet interesi i palëve. Nuk e di unë ku mund t'a gjeni ju ndonjë akt tjetër më thelbësore cënimin e interesit të palëve. Kur nis një garë me 153 kandidatë, të vjen një parti tjetër me 1000 kandidatë, dhe këtu thuhet se s'ka cënim interesi të palëve. Si s'ka?! Një karrocë me 153 kuaj me një karroce me 173 kuaj. Kush, pavarësisht se numri i kuajve nuk ka të bëjë me shpejtësinë e karrocës, por që çenohet në fillim gara, çenohet. Dhe këtu përderisa çenohet gara, nuk e dimë sa është cënimi i garës, por gara me numrin e kandidatëve çenohet, se këtu janë 13 parti, 12 parti, të cilët janë regjistruar me një numër të caktuar kandidatësh. Vjen një parti tjetër, thotë, unë dua dyfishin e kandidatëve. Atëherë këtu, në momentin që ke dyfishin e lojtarëve në garë, këtu ka cënim, se sa është cënimi nuk e dimë pastaj. Prandaj ju lutem mos paragjykoni vendimmarrjen e themelit në një kërkesë formale procedurale, si dhe praktikën dhjetravjeçare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ne prandaj jemi këtu. Ne kemi

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

hyrë në proces administrativë, prandaj jemi subjekte, dhe në Kodin Zgjedhor ne s'kemi të drejtë vote si përfaqësues partish por jo që nuk kemi të drejtë.

**Z. E. Lako:** Mirë zoti përfaqësues i partisë, e kuptuam, arsyetimin do t'a bëjë KAS-i në vendimmarrje, kështu që qëndrimin e kuptuam.

**Z.I. Rusmali:** Të bëje dhe një shtesë në raport me reagimin, se ne s'na takon t'i futemi në këtë pikë të themelit, dhe nuk mund të shkëmbejmë argumente dhe kundërargumente për themelin, se nuk kemi filluar akoma shqyrtim. Ne po diskutojmë vetëm faktin ka interes të ligjshëm për të marrë pjesë në procedurë ankimore apo nuk ka. Në qoftë se i referohemi praktikës së mëparshme, po i referohemi një institucioni me konfigurim tjetër dhe jemi dakord me këtë punë, e para. E dyta, në qoftë se i referohemi praktikës së mëparshme dhe pjesëmarrjes së palëve në procedurë administrative, pra ta them me mirë pjesëmarrësve, pjesëmarrjes së përfaqësuesve permanent të subjekteve zgjedhore. Se po diskutojmë përfaqësues permanent të subjekteve zgjedhore, jo palë. Pjesëmarrjes së përfaqësuesve permanent të subjekteve zgjedhore në procedurë administrative, gjejmë justifikimin pse këta përfaqësues kanë marrë pjesë në procedurat e Komisionerit, por nuk gjejmë justifikimin pse duhet të marrin pjesë në procedurat e KAS-it. KAS-i shqyrton ankimet dhe lidhur me objektin e ankimit, duhet të kesh një interes të ligjshëm që të mund të marrësh pjesë, nuk mjafton vetëm fakti se je subjekt zgjedhor. Subjekt zgjedhor ndiq procedurat administrative të institucionit. Por kjo është vetëm procedurë ankimore.

**Z. E. Lako:** Po zoti Braho!

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*


**Z. L. Braho:** Tani duke qënë se po gjykojmë në lidhje me legjitimitetin si subjekt i interesuar i Partisë Socialiste, ndoshta do të ishte e udhës që të merrnim dhe mendimin e ankimuesit në lidhje me këtë fazë. Pra për ankimuesin, a konsiderohet Partia Socialiste subjekt i interesuar apo jo? Pastaj mund të dalim ne në një vendimmarrje, më duket më e drejtë edhe proceduralisht.

**Z. K. Bele:** Me falni. Kisha dhe unë një koment. Unë mendoj që pa paragjykuar vendimin e themelit, jo thjesht për praktikë por duke pasur parasysh natyrën e kësaj kërkesë dhe efektet që mund të sillte një vendim eventual, cilido qoftë ai, unë mendoj që subjektet zgjedhore në këtë rast, dy apo më shumë prezente, se kanë bërë kërkesa, kanë një interes aparent të ligjshëm, dhe mendoj që lënia në brenda kufirit që jep ligji, por dhe në respektim të një tradite, sepse ky është një proces vërtetë administrativ, por është “sui generis”, pasi është një proces administrativ me subjekte politike të cilat janë të akredituar. Pra, duhet të kemi dhe këto konsiderata para vendimmarrjes tonë. Faleminderit!

**Z. E. Lako:** Atëherë po, kërkuesi.

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti kryesues! Është e vërtetë dhe ajo ç’farë tha kolegu i Partisë Socialiste, përsa i përket traditës së institucionit, pra që rëndom në këto shqyrtime, duke qënë që edhe procesi i shqyrtimit paraprak dhe procesi ankimor drejtohej nga e njëjta trupë, ky ka qënë konfigurimi, por gjej me vend arsyetimin që bëri anëtari i KAS-it, z.Rusmali, përsa i përket lidhjes së procesit nëpërmjet paraqitjes së listave midis subjektit zgjedhor dhe subjekteve në vetvete, kandidatëve, në qoftë se do t’i konsiderojmë të tillë, me institucionin. Pra është një, në këtë rast besoj që interesi i ligjshëm do të ishte vetëm i subjektit i cili ka investuar

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

KAS-in dhe/ose i kandidatëve të cilët në një mënyrë ose një tjetër rezultojnë me listë ose jo, me ose pa pëlqimin e tyre, pra këta do të ishin të vetmet subjekte që do të prekeshin nga vendimmarrja, ashtu siç janë prekur nga vendimmarrja objekt shqyrtimi përpara KAS-it, pasi është institucioni që disponon, pranon ose jo vullnetin e subjektit zgjedhor. Vullneti i cili siç e kemi thënë edhe në kërkesën tonë ankimore është Sovran, dhe nuk mund të gjykohet përveçse formalisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në momentin e regjistrimit. Pra në këtë mënyrë, prekje eventuale të interesave të tjerë, të subjekteve të tjerë, aq me tepër që në momentin e marrjes së këtij vendimi, të 156-shtës, interesat e tyre të ligjshëm ishin ezauruar, pra subjektet e tjerë ishin regjistruar në përputhje me vullnetin e tyre të shprehur në listën shumemërore, unë për të thënë të drejtën nuk gjejë. Në këtë kuptim do t'a pranoja si me shumë vend arsyetimin që në çështje të kësaj natyre kur kanë të bëjnë specifikisht me të drejta të kësaj natyre sovrane të një subjekti zgjedhor përsa i përket institucionit, interesi i vetëm i ligjshëm është i subjektit që i drejtohet dhe eventualisht i kandidatëve që ndodhen në listën e tij, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Kaso. Zoti Çefa, keni ndonjë koment?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Z. E. Saliانji përfaqësues i PS-së:** Nuk e di, prisja nga zoti Kaso që të ishte me vulnerabël me këtë arsyetim, se kjo është një praktikë për mua që në këtë rast hiqet e drejta e Partisë Socialiste që të jetë në një proces, por nuk e doja në asnjë rast tjetër që kjo praktikë të ndodhte në rastin kur do të ishim, do të kërkonte Partia Demokratike. Dhe së dyti përsa i përket arsyetimit, nuk e, pavarësisht se këtu është interesi, dhe interesi të sjellë të bësh dhe arsyetimin, por në qoftë se do të ishim të

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

ligjshëm, ne duhet të mendojmë një fakt, në qoftë se Partia Demokratike do të sillte një liste me kandidatë të cilët nuk lejohen të jenë kandidatë, që janë shkelje të Kodit Zgjedhor, ka të drejtë një subjekt ta ankimojë, po apo jo?! Po. Cili është subjekti?! Të gjithë subjektet kanë të drejtë t'a ankimojnë. Në rastin konkret kjo listë e cila vjen për t'u miratuar sot, nuk ka një natyrë shkelje që mund të ishte një ushtarak, një gjeneral në listë dhe ne na lindte e drejta për t'a ankimuar, por ka disa shkelje të tjera dhe ne jemi në proces. Me këtë arsytim që ju bëni dhe vendimmarrjen që mund të merrni, ju hiqni të drejtën që nesër ç' do parti ta ankimojë listën. Nuk mund të ankimohet lista. Pra me këtë vendimmarrje që do të merrni, nesër në qoftë se do të vijë një listë në shkelje të ligjit, do të thuhet nga partitë e tjera, vendimi i KAS-it i cili është një praktikë, se ju do të jeni edhe për katër vjet, nuk mundet, lista është vullnet, por jo more zotëri, vullnet kur e paraqet, pastaj tek vendimmarrja janë, hyjnë interesi i palëve. Dhe me këtë argument siç e thatë në fillim nuk mund të hiqni të drejtën e ankimit, se me këtë ju më keni heq të drejtën e ankimit të subjektit zgjedhor për një shkelje që mund të bëhet. Shpresoj mos të ketë nesër. Prandaj mendoheni vendimmarrjen, mos e mendoni ngushtësisht në lidhje me këtë proces, por mendoheni se me këtë vendimmarrje ju hiqni të drejtën e çdo partie nesër, subjekti që të kundërshtojë listën dhe kur janë në kundërshtim me ligjin kur i jep, për arsye se, përderisa nuk lejon të futesh në proces si person i interesuar, se të drejtat e personit të interesuar janë njësoj me të drejtat e ankimuesit, ka të njëjtën pozitë procedurale ankimuesi me personin e interesuar, pavarësisht se unë, me këtë vendimmarrje ju nesër, Komisioneri do të marrë një vendim, do të thuhet që për listat është vullneti i palëve, pra këtu ç' do gjë mund të ankimosh tek KAS-i, dhe mund të hysh si person i interesuar, kurse për listat e cila është për mua vendimmarrja më e rëndësishme për procesin zgjedhor, se aty është pariteti i palëve. Ka Kodi Zgjedhor shumë nene e dispozita të cilat duhet t'i respektosh kur vish për listat, se mund të

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

ishim në rastin që s'kishte plotësuar asnjë, Partia Demokratike nuk do të plotësonte asnjë kërkesë të vendimit plotësues të KQZ-së, Komisioneri do ta kishte miratuar dhe ne s'do ankimonim dot se do të thoshin, shiko kjo vetëm kjo pjesë është vullnet i palëve.

**Z. E. Lako:** E qartë zoti Eridian, mos ta paragjykojmë dhe vendimmarrjen e KAS-it. Për hir të debatit edhe mendimi im është që kërkesa duhet pranuar, për arsye se ky është një proces i tërë administrativ, dhe ka filluar që me një vendimmarrje të mëparshme të Komisionerit, ku subjekti që bën kërkesën Partia Socialiste ka qënë palë në këtë proces dhe patjetër që është e interesuar për këtë çështje sepse ka pasur një vendimmarrje, ka pasur një pranim të kësaj vendimmarrje nga KQZ dhe kjo ka qënë pjesë e procesit. Dhe patjetër që vendimmarrja që do të marri KAS-i në këtë ankim është dhe e përfshin dhe i shtrin efektet edhe tek subjekti që ka paraqitur kërkesën, prandaj për mendimin tim kjo kërkesë duhet pranuar dhe vetëm do t'i bëjë mirë procesit, nuk është se e dëmton apo krijon ndonjë pabarazi, përkundrazi. Kështu që unë i ftoj anëtarët e KAS-it që të shprehemi tani për vendimmarrjen sepse besoj se, në qoftë se s'ka dikush tjetër ndonjë kërkesë apo ndonjë. Po mirë, atëherë na falni të tërhiqemi për të marrë vendim dhe do t'iu thërrasim prapë shumë shpejt, faleminderit.

**Rifillon Mbledhja ora 10:33**

**Z. E. Lako:** Atëherë vazhdojmë procesin. Në mbështetje të pikës 3 të nenit 133 të Kodit Zgjedhor, KAS-i vendosi pranimin e palës së interesuar unanimisht, interesat e të cilës ka të ngjarë të preken nga vendimi që ne mund të japim në përfundim të

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

procedurës administrative. Atëherë vazhdojmë me procesin. Kam një pyetje për palët, që ka ndonjë kërkesë paraprake sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor?

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Jo, nuk kemi.

**Z. E. Lako:** Nuk ka! Ne vetë anëtarët e KAS-it kemi ndonjë rast konflikti apo? Nuk kemi! Atëherë vazhdojmë, nëse nuk ka kërkesa paraprake, vazhdojmë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Ftojme fillimisht Sekretarin e Përgjithshëm, të bëjë dhe njëherë një paraqitje të shkurtër të ngjarjes.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë “Koalicioni Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim, PD-AN”, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend për datën 25 Prill 2021. Ka paraqitur kërkesën pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të miratuar listat shumemërore të koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim. Në datën 10.03.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka disponuar për kthimin e listës shumemërore për plotësim duke qënë se numri i paraqitur i kandidatëve në listat shumemërore ka qënë me tepër se ç’është përcaktuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Brenda afatit ligjor koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim” ka sjellë listat shumemërore.

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. Y. Merkaj:** Duke paraqitur listat shumemërore në 12 qarqet, edhe në dokumentin e korigjuar osë të ri sjellë në KQZ, përsëri është konstatuar se listat shumemërore të këtij koalicioni, kanë qenë më tepër se çfarë ka qenë e përcaktuar në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pothuajse të gjitha qarqet kanë nga 3 dhe deri në 9 emra në listë shumemërore më tepër se sa ka qenë i përcaktuar. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka vendosur, pra miratimin e listave shumemërore, por duke e vendosur kufirin siç ka qenë i përcaktuar për Qarkun e Beratit nga numri 1 në numrin 9, për Qarkun Dibër nga numri 1 në numrin 6, për Qarkun Durrës nga numri 1 në numrin 15, për Qarkun Elbasan nga numri 1 në numrin 15, të listës shumemërore, për qarkun Fier nga numri 1 deri në numrin 18 për listat shumemërore, për Qarkun Gjirokastrë nga numri 1 në numrin 6, për Qarkun Korçë nga numri 1 në numrin 12, për Qarkun Kukës nga numri 1 në numrin 3, për Qarkun Lezhë nga numri 1 në numrin 9, Qarku Shkodër nga numri 1 deri në numrin 9 dhe në Qarkun Tiranë nga numri 1 në numrin 36 dhe Qarku Vlorë, qarku i fundit nga numri 1 në numrin 12. Duke mos qenë dakord me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, në datën 19.03.2021, ka depozituar në KQZ, kërkesën ankimore duke kundërshtuar vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në arsyet e kërkesës paraqet se lista shumemërore duhet të jetë me numrin e paraqitur nga Partia Demokratike dhe nuk është dakord me kufirin ose me reduktimin e listës që i ka bërë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti sekretar i përgjithshëm, atëherë ftojme përfaqësuesin e subjektit të ankuar zoti Kaso, për të paraqitur pretendimet mbi çështjen!

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti drejtues i seancës. Ateherë siç u relatua edhe nga administrata, Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, ka depozituar konform afatit ligjor, listat shumemërore të kandidatëve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, listat të cilat janë marrë në shqyrtim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për të verifikuar fillimisht në qoftëse plotëson kriteret e nenit 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor. Pas këtij verifikimi paraprak, me anë të vendimarrjes numër 131 të datës 10.03.2021, po ky Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve, ka disponuar për kthimin e listave shumemërore për plotësim, Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, për disa arsye, ndër një prej të cilave është edhe arsyeja që është bërë motiv mos dakordësie ndërmjet nesh dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Arsyet kryesore, pra në masën e tyre më të madhe kishin të bënin me disa pa rregullsi të aspektit procedural dhe formal të dokumentacionit të paraqitur, pra që lidheshin kryesisht me formatin dhe masën e dokumentacionit mbështetës, që duhet të shoqëronin listat shumemërore të kandidatëve dhe disa aspekte që duhet të rregullonin parashikimet shtrënguese ligjore për sa i përket respektimit të kuotës gjinore sipas parashikimeve të ligjit, pra që në çdo 3 emra, 1 prej tyre t'i përkiste gjinisë më pak të përfaqësuar, vërejtje dhe parregullsi të konstatuara këto, të cilat përsa i përket këtyre aspekteve proceduriale dhe formale qëndronin dhe gjithashtu një prej arsyeve të Komisionerit në momentin e disponimit me këtë vendimarrje, pra të kthimit për plotësim, ka qenë ai që listat shumemërore të kandidatëve të Koalicionit të udhëhequr nga Partia Demokratike në secilin qark, e tejkalonin numrin maksimal të kandidatëve të lejuar, një shprehje e çuditshme kjo në këndvështrimin tonë, pasi leximi që ne i bëmë dispozitës, veçanërisht nenit 67, pika 4, nuk vërejmë që dispozita të përmbajë ndonjë limit maksimal kandidaturash të lejuara. Nga ana jonë si subjekt, brenda afatit që parashikonte vendimarrja e datës 10.03.2021, kemi operuar me plotësimin e


*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

parregullsive të konstatuara, këto të aspektit procedural formal si dhe duke operuar në disa raste me ri renditje të listës për sa i përket pjesëve ku lista jonë shumëmemërore nuk respektonte kriteret shtrënguese të ligjit, për pasqyrimin në këto, në mënyrën e duhur dhe ruajtjen e kuotës gjinore. Gjithashtu nga ana jonë është gjetur pa vend vërejtja ose konstatimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për sa i përket tejkallimit të numrit të lejuar të kandidatëve në listat shumëmemërore në pothuajse të gjithë qarqet e vendit dhe në momentin në të cilin e kemi ri depozituar listën tonë shumëmemërore brenda afatit të përcaktuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për këtë pikë kemi ngritur shqetësimin tonë dhe kemi bërë interpretimin tonë, të detajuar të dispozitës e cila na lejonte që të paraqisnim atë numër kandidatësh që kemi paraqitur. I kemi bërë me dije Komisionerit, gjithë arsyet tona ligjore, në këndvështrimin tonë se përse lista jonë duhet të kishte 222 kandidatë, ashtu siç edhe kishte. Nga ana e Komisionerit është operuar me, në momentin që ka patur vendimarrje për sa i përket këtyre listave shumëmemërore të Koalicionit, janë gjetur të plotësuara vërejtjet e tjera për sa i përket aspektit procedural dhe formal dhe duke qenë që Komisioneri vazhdonte t'a lexonte dhe t'a interpretonte në të njëjtën mënyrë dispozitën ligjore, nenin 67 pika 4, ka operuar me një reduktim të listës në qarqe të ndryshme, pra në të gjithë qarqet, sipas interpretimit që Komisioneri i bënte dispozitës, duke aplikuar një numër maksimal të lejuar kandidaturash për çdo qark. Kjo vendimarrje është në kundërshtim me ligjin për këtë pikë, pra për sa i përket në rradhë të parë konstatimit që listat shumëmemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, e tejkalojnë numrin e lejuar të kandidatëve në to, pasi nga leximi dhe letrar dhe historik që i bëhet dispozitës veçanërisht nenit 67, pika 4, por edhe ligjit në tërësi, nuk gjejmë që të ketë dispozita ose ligji ndonjë limit maksimal kandidaturash, që duhet të përmbajnë listat shumëmemërore të subjekteve që regjistrohen në zgjedhje sikundër koalicioni ynë, por në këndvështrimin tonë

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

përmban ashtu siç historikisht kjo dispozitë ka përmbajtur, një numër minimal, pra një numër dysHEME kandidaturash në listat shumëmemërore të kandidatëve. Kemi kundërshtuar këtu përpara jush gjetjen e Komisionerit, në rradhë të parë dhe së dyti kemi kundërshtuar përpara jush veprimin e tij në interpretim dhe zbatim të gabuar të dispozitës ligjore, kur kryesisht ka reduktuar ka operuar me reduktimin e listës. Një moment procedural ky, i cili nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor. Më lejoni që t'ju lexoj edhe njëherë dispozitën pavarësisht se ju sikundër edhe ne e kemi shumë të qartë, dispozitës së cilës i referohemi përse i përket objektit të kësaj mosmarrëveshjeje me Komisionerin, pra neni 67 pika 4, kur flet për listat e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive, përveçse në pikën 1 përmban kriteret shtrënguese, pra kush duhet të paraqesi listë dhe çfarë momenti kohor para datës së zgjedhjeve duhet të paraqitet kjo listë, në pikën 4 jep edhe modalitetet sesi duhet të paraqitet lista përse i përket çdo zone zgjedhore, duke cituar emrat në listën shumëmemërore të subjektit zgjedhor; paraqiten të renditura sipas rendit shifror duke filluar nga numri 1, kriter të cilin e përmbushin të gjithë listat tona, numri i kandidatëve në listën shumëmemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse e shtuar dy, kriter të cilin e përmbajnë listat tona, pasi kjo fjali nga interpretimi letrar i saj përcakton rregullin që, të gjitha listat duhet të përmbajnë një numër minimal kandidatësh që duhet të jetë i barabartë me numrin e mandateve që shpërndahet në zonën zgjedhore, shtuar 2. Ky është rregulli përse i përket numrit minimal dyshemesë që, secila listë duhet të ketë dhe fjalia tjetër lidhet me një kriter tjetër të rëndësishëm dhe me dispozita të tjera të cilat kanë për qëllim që ta bëjnë realitet, ta materializojnë mbrojtjen për sa i përket kuotës gjinore, ku kërkohet që në çdo rast numri i kandidatëve në listën shumëmemërore duhet të jetë i plotë pjestueshëm me numrin 3, pra ky është kriteri tjetër i vetëm i ligjit, përtej dyshemesë që vetë dispozita përcakton, pra kemi të bëjmë

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.23.03.2021*

me një dysHEME, numri i plotë i mandateve që shpërndahen plus 2 dhe përsa i përket tavanit, dispozita nuk parashikon tavan por parashikon një kriter tjetër që çfarë do lloj numri kandidaturash subjekti politik ta gjykojë të përshtatshme të paraqesi në një zonë zgjedhore përkatëse, ky numër duhet të jetë i plotë pjestueshëm me 3, me qëllimin e vetëm që parashikimi tjetër që të paktën 1 në çdo 3 kandidatura duhet ti përkasë gjinisë tjetër, gjinisë më pak të përfaqësuar të materializohet dhe të jetë real edhe në praktikë, edhe këtë kriter të gjitha listat tona për çdo zonë zgjedhore, pra çdo qark, të gjithë numrat që janë paraqitur nga ana jonë janë të gjithë të plotëpjestueshëm me 3, pra ne, gjithashtu fjalia tjetër thotë që, përbri koalicionit, për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati dhe këtë kriter e kemi plotësuar nga pikëpamja formale. Pra vlerësojmë që listat e paraqitura nga ana jonë, janë në përputhje të plotë me dispozitën ligjore, dispozitë e cila siç themi edhe ne në ankimimin tonë, gjithmonë ka përmbajtur kufij minimal pra dyshemenë e nevojshme dhe të mjaftueshme të cilën subjektet zgjedhore, qofshin këto parti politike ose koalicione duhet të paraqesin në momentin e regjistrimit të listave shumëmemërore. Lexoj këtu për analogji Kodin e mëparshëm, pra përpara ndryshimeve të korrikut 2020, kur kjo dispozitë ka ndryshuar, e cila më lejoni i njëjti nen në pikën 5 të tij, përmban këtë parashikim: Emrat në listën e partisë paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri 1. Numri i kandidatëve në listën shumëmemërore të një partie të regjistruar si subjekt zgjedhor më vete apo numri i përgjithshëm i kandidatëve të një koalicioni, nuk duhet të jetë më i vogël sesa numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse. Për një parti vazhdon, pjesëtarë të koalicionit numri i kandidatëve nuk mund të jetë më i vogël sesa gjysma e mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse. Pra, edhe dispozita përpara se të ndryshohej ka patur këtë logjikë historike dhe mund të citoj edhe kodet më përpara, ku parashikimi i vetëm shtrëngues ka qenë vetëm për një numër minimal

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

kandidaturash dhe asnjëherë kjo dispozitë nuk ka patur tavan maksimal. Gjithashtu, një argument tjetër që e kemi parashtruar edhe në ankmin tonë, kjo bëhet akoma më reale në kushtet kur Kodi Zgjedhor ka ndryshuar dhe dispozitata që parashikojnë regjistrimin e koalicioneve dhe paraqitjen e listës së tyre shtrëngojnë të gjitha partitë pjesëtare në një koalicion zgjedhor, që të paraqiten dhe të regjistrohen me një listë të vetme. Në qoftëse dispozita do të lexohej në mënyrë shtrënguese siç e ka lexuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kjo do të mohonte të drejtën e partive pjesëtare në një koalicion që të paraqisnin të paktën nga një kandidatë të tyre në zonat zgjedhore, në një garë zgjedhore, sepse numri i mandateve që shpërndahen në qarqe, pra në zona zgjedhore në qarqe, në pjesën më të madhe të tyre, në rastin konkret për shembull është më i vogël sesa numri i partive që përbëjnë koalicionin i cili është regjistruar nën emrin Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim. Vlerësojmë që një dispozitë ose aq më keq leximi shtrëngues dhe i gabuar i kësaj dispozite nuk mund ti prekludojë të drejta të garantuara me Kushtetutë, siç është edhe liria e asociimit, i cila lejon çdo subjekt politik që të asociohet në mënyrën që e gëjkon më të përshtashme në një garë elektorale dhe të garojë duke paraqitur alternativën e vet nëpërmjet kandidatëve të vet. Gjithashtu nëqoftëse leximi i dispozitës do të ishte po kaq shtrëngues do të vintë në vështirësi, le të themi dhe aplikimin e dispozitës në praktikë përse i përket qarqeve që kanë një numër të kufizuar mandatesh, për shembull po marr këtu Qarkun e Kukësit, çfarë do të ndodhte nëqoftëse një, e drejta e koalicionit ose e një partie politike për të paraqitur kandidat në Qarkun e Kukësit do të ishte e barabartë thjesht dhe vetëm me numrin e mandateve që shpërndahen në këtë zonë zgjedhore, pra pa i aplikuar shtesën 2 e cila është garanci për raste eventuale të dorëheqjes nga mandati, ose raste eventuale të pa përputhshmërisë së personave të cilët e kanë marrë mandatin me ushtrimin e detyrës më pas, të deputetit, pra çfarë do të ndodhte në qoftëse një subjekt politik do ti fitonte 3 mandatet në

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.23.03.2021*

Qarkun e Kukësit dhe në rastin më të mirë, njëri prej deputetëve të zgjedhur do të garonte në një garë tjetër siç ishte, le të themi gara për organet e qeverisjes vendore dhe do të detyrohej të dorëhiqej nga ky funksion ose në rastin më të keq, do të kishte pa mundësi të përhershme për ta ushtruar atë funksion. A do të ndërhynte aplikimi shtrëngues i kësaj dispozite mbi aspekte të tjera të stabilitetit të organit më të lartë ligjvënës ose qoftë edhe në rastin më ekstrem, në stabilitetin e një qeverie legjitime të dalë nga zgjedhjet? Pra, ka shumë aspekte që preken nga aplikimi strikt, formal dhe i gabuar i dispozitës e cila në kuptimin e saj të parë dhe literal, është shkruar dhe mbetet e shkruar, shumë e qartë për ne, besoj që është një çështje që Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, duhet ta marrë në konsideratë serioze pasi vendimarrja e sotme sigurisht që do të ketë efekt për regjistrimin dhe të drejtat e koalicionit të udhëhequr nga Partia Demokratike, por dhe të kandidatëve të përmbajtur në listat tona, por sigurisht do të vendoset dhe një precedent të rëndësishëm mbi mënyrën sesi duhet të konfigurohen në të ardhmen listat shumemërore të subjekteve që regjistrohen në garën zgjedhore, qofshin këta koalicione ose qofshin parti politike. Prandaj jemi drejtuar dhe ju kemi investuar me këtë kërkesë dhe prandaj kërkojmë nga ana juaj që të merret në shqyrtim vendimarrja numër 156, e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke e shfuqizuar atë në pjesën që disponon për tejkalimin e numrit të lejuar të kandidaturave në listat shumemërore, në të gjitha zonat zgjedhore dhe reduktimin e saj, pra duke vendosur ju si komision që Koalicioni Partia Demokratike, të regjistrohet me listat që i ka paraqitur në mënyrën që ajo i ka gjykuar të arsyeshme në bazë të vullnetit të saj sovran dhe të partive që përbëjnë koalicionin e saj, në bazë të nevojave politike për t'u përfaqësuar sa më mirë në garën zgjedhore dhe për të maksimalizuar atë ç'ka është e saj, pra votën e saj dhe të regjistrohen të plota ashtu siç i kemi paraqitur. Kaq, shkurtimisht i nderuar, ju falenderoj!

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*


**Z. E. Lako:** Faleminderit z.Kaso! Keni ndonjë provë, apo fakt, për të mbështetur pretendimet tuaja, apo thjesht i mbështesni mbi interpretimin e ligjit, Kodit Zgjedhor?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar! Nuk kemi prova dhe fakte të tjera, përtej vendimarrjes së Komisionerit të cilin e kemi bashkëlidhur. Vendimarrje e cila në fashikullin e saj të drejtuar Komisionerit ose që gjendet këtu në KQZ, përmban edhe listat përkatëse, të cilat nuk e kemi parë të arsyeshme ti depozitojmë të veçuara, meqënëse janë pjesë përbërëse e fashikullit të vendimarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve!

**Z. E. Lako:** Faleminderit zoti Kaso! Atëherë të vazhdojmë të mbarojnë të gjithë palët, apo...Atëherë!

**Z. I. Rusmali:** Ju zoti Kaso thatë që mënyra sesi ka, domethënë vendimi i Komisionerit, praktikisht cënon të drejtat tuaja si koalicion, mund ta shpjegoni më qartë këtë, se unë nuk e shoh domethënë, një listë e gjatë me njerëz, të cilët mund të futen, pse u pengoka koalicioni që të hartoj listën, kur numri për shembull është 153.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Rusmali! Sigurisht në këndvështrimin tonë çënohen të drejtat tona si koalicion, ashtu siç çënohen të drejtat individuale të kandidatëve, të cilët japin pëlqimin për të kandiduar në siglën e koalicionit tonë, ashtu sikundër çënohen në këndvështrimin tonë, të drejtat e partive politike që përbëjnë koalicionin tonë, të drejtën për të paraqitur nga 1 kandidat, që të garojë me siglën e tyre siç e parashikon dhe dispozita.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** E drejta e subjektit politik për të garuar në mënyrën që subjekti politik e mendon, në mënyrën më të mirë të mundshme, në një zonë zgjedhore është e drejtë sovrane e tij, dhe nuk mundet në këndvështrimin tonë, që institucioni në momentin që pranon dokumentacionin që materializon këtë të drejtë sovrane, përtej verifikimit të respektimit të kriterëve thjesht formale, të ndërhyjë në çështjet e vullnetit të brendshëm të subjektit.

**Z. I.Rusmali:** Kjo është temë tjetër. Pyetja ime është: E bëjmë konkrete. Tirana ka 36 deputetë. Koalicioni juaj është 10, sa është?

**Z. I.Kaso:** 13

**Z. I.Rusmali:** 13 parti. Ka vend për secilën parti që të ketë kandidatin e vet në listën e Tiranës. Pengon kjo, apo doni 36 edhe në Kukës, apo minimumi 13 në Kukës? Kush është koncepti juaj për këtë?

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Atëherë, koncepti jonë është që ka një kufi minimal, nuk ka një kufi maksimal, dhe do të donim, në qoftë se do të kishim dëshirë si subjekt që të paraqisnim të paktën 13 në Kukës, sigurisht që do të zgjidhnim një numër më të madh se 13-a, por që do të mund të plotpjesëtohej me 3 për të aplikuar dhe kriterin tjetër ligjor, por që të kishim mundësi ta ushtronim këtë të drejtë në bazë të nevojave thellësisht politike të subjektit sovran, që është koalicioni dhe partitë politike që e përbëjnë atë.

**Z. E.Lako:** Nëse do t'i bëjmë tani pyetjet, pastaj ta mbarojmë, në rregull, vazhdojmë.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. I.Rusmali:** Ju keni kandiduar në të gjithë Shqipërinë 222 veta. Keni shtjelluar që duhet të jetë minimalisht numri i mandateve, plus 2, pastaj folët edhe për kompensimin për nevoja të kuotës gjinore. Në qoftë se ne i zbatojmë kriteret, numri i mandateve, plus 2, dhe bëjmë dhe, për nevojat e kompensimit, dhe plotësimin e listës, numri shkon 177. Ju e keni 222. Ky dallimi midis 177-ës dhe 222-shit, pse s'është e saktë 177-a, dhe pse është i saktë 222-shi.

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Unë besoj që arrihet te numri 177 në total duke rumbullakosur, le të themi duke marrë këtë kufi minimal që edhe ne parashikojmë, dhe arsyetojmë si të tillë, pra numrin e mandateve shtuar 2, dhe më pas duke e rumbullakosur te numri më i afërt i plotpjesëtueshëm me 3, që është një lexim i drejtë, por gjithsesi kufizues, pasi nevojat e subjekteve për t'u përfaqësuar, aq më tepër në rastin e një koalicioni, mund të mos jenë të përputhshme me këtë lexim. Pra, në qoftë se pranojmë logjikën, siç beson, besoj që edhe Komisioneri deri në njëfarë pike e ka pranuar, por nuk e di pse është tërhequr gjatë vendimmarrjes që, kufiri është kufi minimal, atëherë çdo numër tjetër i plotpjesëtueshëm me 3, jo vetëm numri më i afërt i plotpjesëtueshëm me 3, është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për t'u paraqitur si numër kandidaturash në listat shumëemërore. Pra, në rastin konkret, shembulli që ju bëtë do të ishte një numër i pranueshëm sipas dispozitës, por ndoshta jo i përshtatshëm sipas logjikës politike, ose interesave për t'u përfaqësuar në rastin e një subjekti zgjedhor.

**Z. I.Rusmali:** Sa kohë që e keni subjektin këtu, dhe zoti Kaso ka qenë historikisht përfaqësues i subjektit. Në zgjedhjet e kaluara ku i kishte kufijtë lista juaj? Ju na

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*




**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

lexuat dispozitën. Ndonjë shembull nga lista juaj, ose në qoftë se e dispononi, a ia jepni dot komisionit listën tuaj të zgjedhjeve të kaluara?

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit për pyetjen! Unë besoj që dispozita duhet lexuar me të njëjtin këndvështrim, siç ka qenë, si unë e lexova, pra, siç ka qenë përpara ndërhyrjeve në dispozitë, në ndryshimet e korrikut të vitit 2020, përsëri në të njëjtën mënyrë lista nuk ka përmbajtur kufij maksimalë, por duhet të kujtojmë që në vitin 2017 lista jonë ka patur një logjikë tjetër, pasi për shkak të ndryshimeve që u bënë në momentin e fundit në garën zgjedhore, nuk u lejua në garën zgjedhore të vitit 2017 që të garohej me koalicione, pra listat të cilat patën kohë dhe afat që të paraqiteshin, pasqyronin vullnetin ose nevojën e vetëm një subjekti politik, dhe jo të një koalicioni partish. Kështu që aplikimi, jo nuk e mbaj mend numrin e saktë, por mbaj mend që aplikimi praktik i kësaj dispozite, që përsëri nuk përmbante kufi maksimal, nga pikëpamja praktike lidhej me nevojën e përfaqësimit të një subjekti të vetëm, dhe jo të një grupimi partish.

**Z. L.Braho:** Në lidhje me kërkesën që bëri zoti Rusmali, në fakt unë e kam kërkuar dhe e kam gjetur, është vendimi nr.339, në mos gaboj, i datës 25.06.2017, që ka pranuar listën e partisë, subjektit zgjedhor Partia Demokratike, të vitit 2017. I kam kërkuar dhe administratës së KQZ-së, në qoftë se është e mundur që ta kemi, dhe s'e di..., Olsi, është vendimi bashkë me listat bashkëlidhur? Po të vihet re, lista e Qarkut Tiranë, të paktën, mbyllet me numrin 50. Pra, këtu janë bashkëlidhur gjithë listat dhe është Qarku Berat 7, Qarku Dibër 9, Qarku Durrës është 19, 20 Elbasani, Elbasani 20, Fieri është 21, Gjirokastra është 9.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. I.Rusmali:** Në rregull, Berati ka pas 7. Sa është Berati? Sa ka qenë lista?


**Z. L.Braho:** Berati s'ka lëvizur, 7 është. Në qoftë se i referohemi të paktën rastit të Tiranës është 50, që e tejkalon dhe atë plus 2-shin e sotshëm. Pra, në qoftë se sipas teorisë së plus 2-shit dhe plotpjesëtimit me 3 do të duhej të kishte 39, në vitin 2017 kanë qenë 50 kandidatë. Nuk e di sa janë sot, sa është lista që propozon Partia Demokratike sot? Jo vetëm për Qarkun Tiranë.

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** 45.

**Z. L.Braho:** Pra është më pak sesa në 2017-ën.

**Z. K.Bebe:** Më fal, tek zoti Kaso, ja një minutë të mbaroj dhe unë një pyetje, meqenëse jemi këtu. Ju folët, që e interpretuat se është e drejta sovrane, por, pra, në interpretimin tuaj zoti Kaso, lista mund të jetë infinit. Ose për ta ngushtuar, duke qenë se në Shqipëri janë diku te 70 apo 80 parti politike, dhe në kujtesën time më të mirë, në zgjedhjet e, para dy zgjedhjesh apo diçka, kemi pasur edhe koalicione nga dyzet e ca veta. Pra, ne mund të supozojmë që një subjekt, cilido subjekt zgjedhor, mund të bashkohet në koalicion me 50 subjekte të tjera. Dhe, mund të kishim një situatë në plotësim të konceptit që ju e parashtruat dhe që në pamje të parë mund të bënte sens, që në 12 qarqe, ky subjekt, ky koalicion të kishte minimumi nga 50 kandidatë, pra të na vinte me një listë me 600 kandidatë. Duke pasur parasysh sot, që ne kemi një rregullim, gjithashtu të ri, në Kod, përveç riformulimit të kësaj dispozite, e cila duhej të ishte shkruar më qartë, e ka thënë

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

drejtësisht Komisioneri dhe mendoj që nuk do shumë analizë për ta kuptuar por, a mendoni sot që me ndryshimet që ka Kodi në drejtim të listave të hapura ku njerëzit do votojnë dhe për kandidatin parapëlqyes, qoftë ky numër, qoftë ky emër. Se, nuk ka akoma një vendim të Komisionit. Ne duhet të konsiderojmë që dhe procesi zgjedhor ka limite kohore, limite materiale, do duhet të kemi në konsideratë dhe numërimin, etj,etj. A do ishte funksionale që subjektet të vinin me nga 600, apo nga 1 mijë, apo nga 2 mijë kandidatë? Dhe si do prodhohim ne, një fletë, qoftë me 600 numra, qoftë me 600 emra, dhe si do numërohej kjo? Pra dakord, interpretimi i ngushtuar, interpretim i zgjeruar. Mund të them që, interpretimin tuaj e dëgjova me vëmendje, dhe sinqerisht e respektoj mënyrën si e parashtroni, pasi aty përmendet minimumi dhe nënkuptohet maximumi. Pra a mendoni që do të ishte funksionale që një listë që po them unë, me 600 emra, për mos të thënë 6 mijë emra, se infiniti është sa të duash? Këtë pyetje kisha zoti Kaso.

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar! Unë jam i mendimit personalisht që dispozitat e Kodit duhet të jenë, të lexohen që të gjitha në harmoni dhe të krijojnë një rezultat, një produkt përfundimtar, i cili të jetë i arsyeshëm dhe i menaxhueshëm nga institucioni që organizon zgjedhjet. Por, sigurisht ishte një sensibilitet që do duhej të ishte marrë parasysh, kjo që ngritët ju, në momentin që legjislatori, me vullnet të njëanshëm ose jo, ka operuar për të ashtuquajturën hapje të listave. Proces ky, i cili ka ndodhur pasi dispozita është formuluar në këtë mënyrë. Pra, në qoftë se mbajmë mend në mënyrë të drejtë diskutimet që janë bërë edhe gjatë, dhe përpara formulimit të dispozitës, dispozita është formuluar në këtë mënyrë me një qëllim që besoj është ai, dhe jam korrekt me përcjelljen e tij, ai të cilin paraqita. Pra, vendosja e kufirit minimal dhe ruajtja e kuotës gjinore. Sensibilitetet e tjera, të cilat çuan legjislatorin të ndërhynte në një mënyrë të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

shpejtë, të pakonsultuar për të çuar në hapjen e listave, nuk mund t'i gjykoj unë. Sigurisht do të kishte qenë mirë që e ashtuquajtura hapje e listave të merrte kohën e nevojshme për diskutim dhe sigurisht të harmonizohej me të gjithë dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor, por është një sensibilitet që duhet ta kishte legjislatori në atë moment që e bëri dhe sigurisht, interesi tjetër që ka patur parasysh, ka qenë më dominant sesa interesi për të krijuar një harmoni legjislative që të gjithë dispozitat të konfigurinin më pas në një produkt lehtësisht të menaxhueshëm edhe në fletën e votimit. Kështu që, mund të qëndrojë dhe sensibiliteti që ju ngritët, por sigurisht s'mund të jap unë përgjigjen përfundimtare për të. Faleminderit!

**Z.E.Lako:** Unë them që, po të vazhdojë ky debat, unë them ta mbarojmë procedurën.


**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Ju po jepni vendimin tani, ju lutem, për procedurë, do ma japësh pak fjalën apo kam të drejtë ta marr në çdo moment?

**Z. E.Lako:** Patjetër!

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Tani, këtu jemi në një paritet palësh. Tani, ju vazhdoni, ju jeni gjyqtarë, ajo kova juaj u mbush nga kjo palë, ju vazhdoni hidhni, do ta mbushim edhe ne kovën tuaj, por pastaj do...

**Z. E.Lako:** Patjetër, do keni gjithë kohën e nevojshme, dhe gjithë pyetjet dhe sqarimet e nevojshme, prandaj KAS-i ju pranoi si palë e interesuar në proces.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Po ju kujtoj procedurën, që jeni *quasi* gjykatë, veproni si gjykatë, gjykata dëgjon palën, pastaj bën...

**Z. E.Lako:** Patjetër që do keni gjithë kohën.

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Meqenëse ishit në debat, në rregull, vazhdojmë debatin, por në qoftë se vazhdojmë debatin atëherë unë nuk po marr më fjalën, se ju po e zgjidhni çështjen.

**Z. E.Lako:** Edhe në rastin e parë e paragjykuat vendimmarrjen e Komisionit dhe tani do keni gjithë kohën e duhur.

**Z. I.Rusmali:** Mund të hyj unë për procedurë. Të gjitha pyetjet që i bëhen ankuesit janë një ndihmë e madhe për ne, për administratën dhe për palën e interesuar për të kuptuar ku qëndron ankuesi. Nuk i ezaurojmë pyetjet, mund të kemi më shumë për palën e interesuar se ndoshta mund të duam më shumë që të kuptojmë nga pala e interesuar, kështu që, ky lloj debati domethënë, edhe me kërcënime, që unë largohem, edhe unë largohem, nuk ka kuptim. Thjesht na shpërqendron dhe na largon nga fokusi i një çështjeje. Na largon nga fokusi i një çështjeje. T'i bëj ato, një e harrova, mbase më vjen rrugës, por dy pyetje t'i bëj?

**Z. E.Lako:** Patjetër!

**Z. I.Rusmali:** Zoti Kaso, pavarësisht sesa është numri, 600, 1 mijë, 2 mijë, 300, nuk ka rëndësi. Numri i madh i kandidatëve të listës, sado që të jetë, vështirëson fletën e votimit. E bën të vështirë fletën e votimit. Ju si subjekt, domethënë, e

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*


shikoni në korrelacion gjënë? Pra, listën që ju doni me fletën e votimit? Domethënë, s'ka problem, ka problem, në qoftë se ka problem, do e menaxhojmë?

**Z.I.Kaso:** Qartë zoti Rusmali, faleminderit për pyetjen! Është e vërtetë ajo që thatë ju, që nga pikëpamja objektive, një numër tejet i madh do ta rëndonte dhe në rastin ekstrem të saj. Ne mendojmë se një numër tejet i madh do ta rëndonte, dhe një numër ekstremisht i madh siç e mori shembullin zoti Bele, ndoshta do ta bënte të pamundur, menaxhimin e fletës së votimit, por është një sensibilitet, që ne si subjekt, sigurisht e kemi patur në momentin që kemi paraqitur listën me vetëm 222 kandidatë, pasi në rast të një koalicioni siç është koalicioni ynë që ka 13 subjekte me një elektorat të vërtetë që kërkon përfaqësim. Ndoshta po të mos ta kishim patur këtë sensibilitet numri do të kishte qenë edhe më i madh dhe mendojmë që numrat në të cilat jemi ndalur, pavarësisht se dispozita për mënyrën si e lexojmë ne të jep të drejtën që, të paraqitësh numër, s'po them të pafundmë, por edhe më të madh se ky, të kandidatëve. E mbajtem në konsideratë këtë moment dhe arritëm të shifrat që përmbajnë listat tona. Kështu që besoj, që ende është i menaxhueshëm, fleta e votimit për mënyrën sesi ne..

**Z. I.Rusmali:** Në dijeninë tonë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka projektuar dy, tre, katër formatë flete votimi, janë konsultuar me ju. Ne s'i dimë, por ju i dini të gjithë këto. Lista juaj e kandidatëve përputhet me ndonjërin nga këto të tre apo duhet shpikur ndonjë tjetër? Kjo është pyetja.

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Unë besoj që të gjithë formatet e propozuara si draft nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe që janë në proces konsultimi me partitë politike, lejojnë që të menaxhohen së bashku të dy nevojat

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

për atë të regjistrimit të listës kandidatëve, ashtu siç është dhe të konfigurimit në fletën e votimit me çdonjërin nga variantet e propozuara për diskutim.

**Z. L.Braho:** Zoti Rusmali, po hyjmë në debatin e fletës së votimit që nuk është kompetencë e jona. Ai subjekti ka depozituar listën, është marrë një vendim nga Komisioneri Shtetëror, ne po shqyrtojmë atë.

**Z. I.Rusmali:** Në debat po hyni ju. Unë nuk po kërkoj nga këndvështrimi i subjektit, ata nga këndvështrimi i tyre, idenë e tyre, dëshirën, ëndrrën e tyre e kanë përqasur me këtë gjë apo jo? Kaq!

**Z. L.Braho:** Atë besoj do e shpalosë tek Komisioni Rregullator, në qoftë se do i thërrasin, të shpalosin...

**Z. I.Rusmali:** Ne kemi dhe vështirësitë e procesit nga...

**Z. E.Lako:** Zoti Rusmali, për menaxhim më të mirë seancës, të mbarojmë njëherë me palën e interesuar dhe me pretendimet dhe në fund do kemi gjithë kohën e nevojshme për të bërë..

**Z. I.Rusmali:** Dy pyetje kam, do t'ia bëj dhe palës së interesuar...

**Z. E.Lako:** Atëherë, meqë do jetë për të dyja, për menaxhim e bëjmë në fund, mbasi të bëjmë dhe prezantimet...

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*


**Z. I.Rusmali:** Ta marr prej këtij përgjigjen, pastaj do t'i bëj të gjitha pyetjet prapë tek pala e interesuar. Me të njëjtën logjikë, numri i madh i listës krijon probleme me procesin e numërimit, se do numërohen ato vota. Ju e keni marrë në konsideratë këtë fakt, apo jo? Domethënë, proceset, vështirësitë në procesin e numërimit janë minimalisht në dëm të të gjithëve, por në mënyrë të veçantë në dëmin tuaj si subjekt, se jeni, ku e di unë, subjekt opozitar. E keni menduar që sa më e madhe lista, aq më i vështirë procesi?

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit për pyetjen! Po, është edhe ky një nga sensibilitetet që është konsideruar. Është e vërtetë ajo që thatë ju, që numri i madh i subjekteve për të numëruar, e zgjat procesin, dhe tejzgjatja e procesit në parim çënon besimin e procesit, aq më tepër shkon kundër interesit tonë si opozitë, e cila synon që nëpërmjet këtyre zgjedhjeve të vijë në pushtet, por besojmë që nuk e komplikon në një masë të tillë sa ta vonojë në mënyrë domethënëse. Faleminderit!

**Z. I.Rusmali:** Nuk i ndërhyj më zotit Kaso! Të gjitha partitë e tjera janë të regjistruara me 153 kandidatë në listë. Ju kërkonit 222 kandidatë në listë. Prish kjo paritetin e palëve në garë?

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit për pyetjen. Unë besoj që paritetin e kandidatëve në garë do ta prishte aplikimi i diferencuar i dispozitës për subjektet. Mendoj që dispozita aty, ka qënë e qartë për të gjithë dhe subjektet kanë patur të drejtë që të marrin të gjitha avantazhet e formulimit të dispozitës për aq sa i ka lejuar legjislatori. Ne si koalicion kemi qënë të përkushtuar dhe të bindur që avantazhet ose disavantazhet nga ana tjetër, sepse na kushtëzon Kodi nga

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

pikëpamje të tjera, por këtë avantazh në këtë pikë të dispozitës për të paraqitur një listë sa më të madhe, sa më përfaqësuese, kemi qenë të përkushtuar t'ia vjelim që të gjitha dispozitës, në momentin që kemi lexuar dhe që kemi paraqitur listën. Përsa i përket subjekteve të tjera, nuk di ta them këtë gjë, domethënë, çfarë sensibilitetesh kanë patur. Faleminderit!

**Z.E.Lako:** Faleminderit zoti Kaso! Atëherë, edhe unë kam disa pyetje, por do t'i bëj në fund të procesit pasi do të dëgjojmë dhe pretendimet që ka lidhur me çështjen pala e interesuar.

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Faleminderit kryetar! Së pari do thoja që në ankim i referohemi ankimit që paraqiti Partia Demokratike, se s'dua të zgjatem, të bëj hyrjet edhe daljet, se këtu për ekonomi kohe u sqaruan.

**Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Në ankim Partia Demokratike i referohet ngushtësisht paragrafit 4, në bazë fjalët së fundi, domethënë shkruar 2, i referohet ngushtësisë së asaj dispozite në paragraf dhe në mbrojtje në parashtesë para jush sot ne duhet ta interpretojmë ligjin në frymën e tij dhe në tërësi. Unë jam dakord me këtë arsyetim me këtë të fundit, në qoftë se do të ecim me parimin që ligji nuk interpretohet te presja te germa por në frymë dhe në tërësi, unë do të thoja se neni 67, pika 4 e Kodit Zgjedhor interpretohet në përputhje dhe me dispozita të tjera të Kodit Zgjedhor si dhe me Kushtetutën. Ligjvënësi ka për të përcaktuar 140 mandate Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe gara bëhet për 140 mandate. Dispozita në të cilën është bërë kjo shtesë dhe arsyetimi pse duhet shtuar rast pas rasti, ka të bëjë së pari është një dispozitë në Kodin Zgjedhor që në këtë rast duhet të referohemi për kuotën gjinore. Që të respektojmë kuotën gjinore duhet të bëjmë një shtesë dhe referohemi te neni 67, pika 4. Së dyti për sa i përket procesit të votimit duhet të jetë një votim i qartë i drejtë kjo realizohet nga lista e votimit dhe këtu duhet të hidhemi në dispozitat e Kodit Zgjedhor për sa i përket përmbajtjes mënyrës sesi është bërë fleta e votimit. Pasi të shqyrtojmë dhe një risi që ka Kodi Zgjedhor që ka të bëjë me kuotat të cilat në përfaqësimin që kandidatët kanë të drejtë të kenë votë parapëlqyese, kjo është risia e Kodit Zgjedhor. Lista duhet të jetë në përputhje që të realizohet kjo risi. Në arsyetimin që bëri Partia Demokratike, votën parapëlqyese për kandidatët, pra listat e hapura shtesat që janë bërë në Kodin Zgjedhor, nuk zbatohet. Në rastin e Kukësit e mori me të drejtë për të gjetur një shembull mori rastin e Kukësit që i tha janë 3 kandidatë dhe përderisa janë 3 kandidatë një nuk mund të jetë dhe ngelet që duhet të ketë një kandidat më shumë, Kushtetuta e ka zgjidhur dhe këtë problem dhe në qoftë ikën një kandidat pra në qoftë se do të jemi në rastin që Partia Demokratike do t'i fitojë të treja mandatet 100% që është një rast që nuk ndodh aritmetikisht. Kushtetuta e ka

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

zgjedhur që Parlamenti funksionon me 139 mandate. Por ky rast nuk mund të mbështetet në një rast i cili nuk mund të ndodhë është rast alogjik se nuk mund të ndodhë në asnjë mënyrë që një parti ta ketë parashikuar ligjëvënësi të marrë 100%. Por unë do të isha dakord që të merrnim shembull këtë rast. Në qoftë se këtu nuk do të cënohej interesi i kandidatëve të cilët sipas nesh i numrit 3 kandidatë, të cilët duhet të garonin dhe të hiqnin të drejtat e barabarta për votën parapëlqyese për listën e hapur. Nëse do të kemi 9 kandidatë që ligji thotë prandaj them do ta lexojmë ligjin në tërësi që do të marrësh një numër jo më pak se 10 mijë vota që të shpallesh deputet. Në Qarkun e Kukësit votojnë rreth 30, 35 mijë zgjedhës, në qoftë se ne do të kandidojmë Partia Demokratike me 9 kandidatë që këtu ne e kemi shkelur Kodin Zgjedhor se asnjë nga kandidatët koncentralisht nuk mund të kapë hersin 10 mijë. Në këtë moment ne do ta kishim hequr të drejtën kjo është e drejta që ka dhënë Kodi Zgjedhor të tre kandidatëve legjitim që të garojnë secili të marrë hersin 10 mijëshin. Në moment që KQZ-ja duhet të pranojë një listë në më shumë se ky numër, atëherë këtyre u mohoet e drejta për një garë të drejtë se në këtë moment në vendimmarrje ajo torta që thuhet 35 mijë do të ndahet në 9. Pra, asnjëri aritmetikisht nuk mund t'i marrë 10 mijë vota, pra secili kandidat është zgjidhur që në fillim gara mund të marrë 5 mijë dhe këtu nuk ka më garë. Pra në këtë lloj vendimmarrje nuk shkelen disa nga dispozitat e Kodit Zgjedhor. Për sa u përket referencave në ligj edhe në urdhëresa, unë besoj që 12 partitë nuk është se nuk e njohin ligjin, por kanë qenë në koherent me vendimmarrjet e KQZ-së si dhe me urdhërat që kanë nxjerrë. Besoj në datën 8 Komisioneri ka nxjerrë një urdhër publik pavarësisht nuk ka qenë e shkruar por është në faqen e tij ku përcakton numrat. Po të jeni si partia kryesore e opozitës ka dijeni për këtë, ajo nuk është udhëresë në formën e shkruar, por është lajmërim që Komisioneri u bën partive politike në datën 8 ku përcakton dhe numrin e mandateve për çdo qark në mënyrë

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.23.03.2021*

të qartë. Ne e kemi lexuar ligjin, kemi marrë njoftimin e Komisionerit, sa është numri i mandateve thashë pavarësisht se është njoftim publik po për ne është barazuar në urdhëra që nxjerr Komisioneri. Për sa i përket argumentit që dha Partia Demokratike që në vitin 2017 ne kemi garuar me 55 kandidatë pra e kemi shkelur atëherë nuk ka qenë dispozita për votë parapëlqyese. Pra dhe në qoftë se ishin 55 nuk shkeleshin dispozitat e Kodit Zgjedhor përsa u përket listave të hapura. Fletët e votimit nuk pengoheshin se fleta e votimit ishte vetëm partia pra ti vërtet mund të kishe një numër të hapur, por këto dispozita që unë them që duhet të interpretohen në mënyrë komulative të gjitha nuk shkeleshin në atë kohë dhe ishte një e drejtë që partitë mund ta ushtronin. Por në rastin konkret kur kemi fletë votimi me emra kandidatësh numra njësoj, kemi garë e cilësoj si garë midis partive garë mbi kandidatët. Kjo shkon në përputhje me numrin të cilët vetë Komisioneri ka përcaktuar si dhe ligji. Nuk mund të marrësh një presje të ligjit dhe ta arsyetosh në favor siç thotë Partia Demokratike po thotë shtuar 2 dhe pjestuar me 3 mund të shtojë çdo numër nuk mund të shkojë 300, 500. Do kemi një parti tjetër dhe do thotë po 500 kandidatë të cilët çfarë do të bëjë me këtë listë do shkatërrojë zgjedhjet pra potencialisht një vendimmarrje në pranimin po të ecim me logjikën që pranohet vullneti i nenit 67, pika 4 dhe lexohet vetëm ajo gjermë që shënuar shtuar 2, pjestuar me 3 pa e arsyetuar me dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor. Ky lloj arsyetimi shkatërron procesin zgjedhor. Që të jemi këtu duhet të shikojmë ku çënohet interesi i ligjshëm. Në asnjë moment Partia Demokratike nuk tha që na çënohet interesi i ligjshëm nga 153 kandidatë sa ka paraqitur të gjithë partitë e tjera dhe kjo e drejtë i është dhënë dhe Partisë Demokratike me 153 kandidatë. Nuk thotë çënimi i interesit të ligjshëm, thotë ne në vullnetin tonë kemi të drejtë të paraqesim dhe më shumë. Në qoftë se numri i kandidatëve në të cilët Partia Demokratike janë miratuar sot nuk i çënohet interesi i ligjshëm vendimi i

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

Komisionerit duhet të rrijë në fuqi. Sa më sipër thashë ftoj Partinë Demokratike që t'i qëndrojë arsytimit që ta studiojmë ligjin në tërësi dhe jo të lexojmë atë presje të ligjit e cila në qoftë se lexohet në tërësi me gjithë dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor besoj vendimi i Komisionerit nuk duhet të ndryshohet, faleminderit.

**Z. E. Lako:** *Faleminderit* zoti Salianji! Edhe për ju kam këtë pyetje, keni ndonjë provë apo fakt?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Jo.

**Z. E. Lako:** Ftoj anëtarët e KAS-it për të bërë pyetje individuale që mund të kenë për palët në proces.

**Z. L. Braho:** Kam unë një pyetje për subjektin e interesuar Partia Socialiste. Mbani mend sa kandidatë keni depozituar me listën e datës 8 Mars? Listë mesa di unë dhe ju u është kthyer fillimisht nga Komisioneri pas depozitimit të parë. Sa ka qenë numri i kandidatëve që ka depozituar Partia Socialiste?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Besoj të njëjtën numër kandidatësh me të cilat është miratuar dhe vendimi për Komisionerin e Partisë Demokratike. Pra mund të citoj, në 153 kandidatë.

**Z. L. Braho:** Në listën e datës 8 Mars, në listën përfundimtare.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Ne kemi depozituar në listën e datës 8 mars në KQZ është lista e datës 8 Mars, ne kemi pasur vetëm një ndryshim për renditjen e një femre në Qarkun Elbasan nuk ka ndryshuar listë. Lista e cila ndodhet pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është lista e depozituar në datën 8 Mars. Doja të shtoja që KQZ-ja është sot vendimi në fuqi i datës 10 që ka kthyer për plotësim

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

listat e Partisë Demokratike dhe në kthimin për plotësim janë vënë disa kushte pse kthehet dhe një ndër këto siç ishte demokralizimi, barazia gjinore, formularët ishte dhe numri i kandidatëve. Partia Demokratike këtë vendim nuk e ka shfuqëzuar dhe ky vendim është vendim kthim për plotësim është në fuqi sot, me shkakun që ke më shumë numër kandidatësh seç duhet. Minimumi po të ishim fair nga ana ligjore, Partia Demokratike duhet ta kishte ankimuar atë vendim dhe do të thoshte që për këtë shkak nuk mund të kthehet lista se mund të ishte ai shkak i vetëm për kthimin e listës. Tani jemi përballë një vendimi i cili është i formës së prerë se nuk është ankimuar që arsyeton që do të kthehet lista për arsye se ka më shumë kandidatë dhe një vendimi tjetër të ..... që ka përcaktuar numri për këtë shkak. Ky shkak për mua është ezauruar me vendimin e parë të kthimit për plotësim, i cili nuk është ankimuar në qoftë se do të interpretojmë ligjin gërmë për gërmë. Nuk është ankimuar ai vendim është në fuqi dhe sot ju vetëm atë vendim mundet ta refuzoni ankimin e Partisë Demokratike.

**Z. I. Rusmali:** Së pari për administratën na jepni dot kopjen e këtij vendimi, sepse mesa duket po bëhet e rëndësishme për arsyetimin tonë.


**Z.Y.Merkaj:** Të cilit vendim?

**Z. I. Rusmali:** Vendimi që përcakton numrin e kandidatëve të listës.

**Z. E. Saliانji, përfaqësues i PS-së:** Është vendim kthim për plotësim që në datën 31, si dhe njoftimi i Komisionerit publik për numrin e kandidatëve nuk ka vendim.

**Z. I. Rusmali:** Ai është njoftim...

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Është njoftim pra Komisioneri ka bërë njoftim pasdite të datës 8 Mars, u bën thirrje partive politike që të depozitojnë listën si dhe numrat e kandidatëve pasi ky debat ka qenë institucioni i KQZ-së.

**Z. I. Rusmali:** E kam të qartë së pari njoftimin na e vini në dispozicion dhe që ta kuptoj më saktë Vendimi nr.131 praktikisht i ka hequr të drejtën subjektivit që të bëjë ankimin për Vendimin nr.156. Një pyetje kam për ju, Partia Demokratike ka prezantuar një listë më më pak se 222 veta në mos gaboj herën e parë që është kthyer mbrapsht, pastaj një listë më të madhe me 222 veta. Një numër subjektsh të tjera elektorale duhet të jenë disa besoj unë nuk i kam identitetet e tyre kanë prezantuar në KQZ lista me nga 177 veta dhe ato janë kthyer për t'u korrigjuar. Pra, ka pasur lexime të ndryshme për dispozitën ligjore të nenit 67. Ju keni ndonjë shpjegim pse kanë ardhur këto lexime të ndryshme pavarësisht atij njoftimit?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Unë e thashë në parashtesë që në qoftë se ligjin e lexonte neni 64, paragrafi 4 pas fjalës "shtohen dy", kjo të sjell një konfuzion për sjelljen e listës dhe pjestohet me 3. Në qoftë se këtë dispozitë e lexon në harmoni me Kushtetutën dhe me dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor besoj që i vetmi kusht që duhet plotësuar shtimi me dy dhe në raste të tjera shtuar dhe 1 është përpjestimi me 3 ruajtje e kuotës gjinore. Pra jemi të detyruar të respektojmë kuotën gjinore i referohemi nenit 64, pika 2 shtojmë dhe 2. Në qoftë se ecim se edhe ne kishim jo 145 kandidatë për Tiranën mund t'i sillnim, por së pari pamë e para logjikisht shkon kjo? Nuk shkon, garon për 36 mandate në Tiranë t'u thuash qytetarëve të Tiranës këta janë 145 kandidatët që kemi ne, pra e hoqëm nga ana logjike. Ligjërisht shkon kjo kur e lexon dispozitën pas presjes që thotë shtuar 2

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

pjestuar me 3 thua po i paska shpëtuar legjislatorit unë paskam të drejtë të pakufijshme. Por kur i referohesh dispozitës që këtu kemi lista të hapura do të thotë që ti në qoftë se do të lexosh ngushtë ligjin, atëherë do të shkelësh nenin tjetër që nuk kemi lista të hapura se aritmetikisht logjikisht ia ke prerë mundësinë të gjithë kandidatëve së cilës nuk janë te lista fituese të hapin hersin. Njoftimi i Komisionerit u bëj me dije ka ardhur para dorëzimit të listave ne këtu jemi subjektet. Jemi interesuar në institucion sesi do të ecim me prezantimet, Komisioneri ka bërë njoftim për të gjithë palët. Besoj se nuk ka pasur asnjë ankimim nga 12 subjektet e tjera të cilëve mund të jenë kthyer dhe 177. Nuk ka pasur asnjë ankimim.


**Z. I. Rusmali:** Ju e keni realizuar vetë interpretimin e dispozitës, pra siç the në fillim po ta lexosh me kujdes me një shkollë juridike normale njeriu arrin ta kuptojë vetë apo keni ndjekur njoftimin e Komisionerit, apo i keni bërë të dyja? Më duhet të shoh dallimin tuaj nga të tjerët që kanë gabuar.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Dallimi i të gjithë neve nga Partia Demokratike jo i tjerëve. Pra, ne jemi 12 subjekte të cilët e kemi lexuar ligjin në tërësi..

**Z. I. Rusmali:** Një grup subjektësh kanë prezantuar lista me 177 veta dhe u janë kthyer mbrapsht, ky është fakt juridik nuk është çështje opinionesh mendon ti apo unë. Mos e diskutojmë këtë punë.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Siç e thashë në parashtrime ne zbatojmë Kodin Zgjedhor si dhe udhëzimet dhe urdhëresat e Komisionerit. Ky njoftim publik për

**Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

ne quhet një urdhër pavarësisht është një urdhër publik dhe nuk është i formës së shkruar por është nga institucioni qendror i zgjedhjeve dhe interpretimi i Kodit Zgjedhor dhe në lidhje me urdhërimin që ka dhënë Komisioneri në datën 8, ne kemi depozituar listat me numër 153.

**Z. I. Rusmali:** Komisioneri në vendimin e vet diku thotë “ ky formulim lë vend për interpretime”, dhe lë vend për interpretime do të thotë mund të kuptohet mënyra të ndryshme nga palët për ju kjo nuk ekziston. Ju e keni kuptuar qartësisht 153 dhe pastaj e keni konfirmuar te Komisioneri.

**Z. E. Saliçani, përfaqësues i PS-së:** Tani në qoftë se ajo dispozitë të ishte shumë e qartë nuk do të ishim këtu as ne, as Partia Demokratike dhe as ju. Pra ajo dispozitë kur e lexon ngushtësisht të jep idenë që shtuar dy pjestohet me tre dhe e ke në mënyrë të pakufishme. Por në qoftë se në këtë dispozitë e lexon në përputhje dhe me dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor si dhe në urdhëresën që unë kam marrë urdhër publik se Komisioneri ka të drejtë të nxjerrë urdhëra dhe udhëzime, urdhëra dhe urdhësa thjesht unë e marr urdhër publik i cili Komisioneri u bën me dije partive politike duke përcaktuar dhe numrin e mandateve për çdo qark. Do ta lexoj juristi por duhet të jetë dhe logjika në mes, shtuar 2 pjestuar me 3 nuk ka numër pakufish ne e dimë 140 mandate janë dhe kështu e kemi lexuar ligjin. Kemi qenë të kujdesshëm duke dështuar vetëm të respektojmë kuotën gjinore se e kemi detyrim. Në asnjë moment nuk e kemi lexuar ligjin që është infinit se në qoftë se do të lexojmë në këtë mënyrë pastaj nuk do kishim zgjedhje në Shqipëri.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

**Z. E. Lako:** Besoj se ishit të qartë zoti Eridian edhe te përgjigja që dhatë për listën fillestare që ka sjellë subjekti juaj pra ka sjellë këtë numër, kështu që i ka mbajtur këtë qëndrim.

**Z.I.Rusmali:** Më doli nga fjalitë e përfaqësuesit të partisë, tani jemi përpara një numri maksimal përcakton dispozita apo jemi përpara një numri fiks që përcakton dispozita?

**Z. E. Saliqji, përfaqësues i PS-së:** Dispozita thotë 67 numri minimal por të le hapësirë që ti do të respektosh kuotën gjinore. Dispozita thotë numri minimal është numri i mandateve, por duhet të kesh parasysh së pari duhet të pjestohet me 3 pse duhet të pjestohet me 3 se duhet të respektohet kuota gjinore.

  
**Zbardhi materialin audio  
Valbona Dushi**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Ai pjestimi me 3 nuk është pjestim me 3 që mund ta pjestosh një numër me 3 se mund të ishte pjestim me 6 por pjesëtimi me 3 është i barazvlefshëm me fjalinë “të respektohet kuota gjinore”se duke ditur që në Kodin Zgjedhor është parashikuar që 1 në 3 kandidatë duhet të jetë patjetër e gjinisë së ndryshme.

**Z. E. Lako:** Pra, është e mundur kur është numër fiks dhe ndryshon për efekt të kuotës gjinore. Po faleminderit zoti Çefa.

**Z. E. Çefa:** Po, faleminderit zoti përfaqësues. Unë kisha diçka që unanimisht vendosëm që ta pranoni përfaqësuesin e subjektit tjetër politik. Si palë e interesuar procesi po vendos përballë koalicionin që ka bërë ankimin me subjektin politik tjetër ndërkohë që unë besoj dhe mendoj që ndoshta gjithë këto pyetje që ne po ia drejtojmë personit të interesuar, ne duhet t’ja kishim drejtuar palës që kemi në proces. Në këtë proces kemi koalicionin ankues dhe Komisionerin kështu që mendoj përpara se të na shpjegojnë, subjekti i interesuar për dispozitën e takonte dhe më përpara për procedurën përfaqësuese të administratës apo Komisionerit që të na sqaronte pak, pasi vendimi ka qenë i tij në fakt. Do kaloja direkt në një pyetje tjetër për administratën se nuk kam pyetje të tjera, nuk e di kush do më përgjigjet, por pyetja ime është termi “Tejkalim i numrit të lejuar të kandidatëve në listat shumëmemërore”. Këtë përkufizim që ka përdorur Komisioneri ka ndonjë rregullim specifik, është parashikuar diku në ndonjë akt ligjor apo nënligjor apo është term i gjetur nga praktika?

**Z. Y. Merkaj:** Nuk ka ndonjë akt nënligjor!

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. E. Çefa:** Pra, Komisioneri gjatë vendimmarrjës konkrete e ka përkufizuar vetë, e ka gjetur ai vetë këtë, nuk ka ndonjë përcaktim tjetër. Faleminderit, nuk kam pyetje tjetër.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, po zoti Braho.

**Z. L. Braho:** Në fakt më shumë sesa pyetje është në formë diskutimi, pasi Kodi Zgjedhor neni 67, ka ndryshuar 2 herë vendimin në 2020-tën dhe herën e dytë ishin ndryshimet e fundit në vitin 2020-të. Janë ndryshuar pikat nga 1-5 ku përfshihet dhe pika 4 që është objekt debati në këtë ankim dhe po të vihet re pika 4 vazhdon me termin që “Nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve”. Nëqoftëse ligjvënësi në fund të vitit 2020-të ku shprehu vullnetin për të hapur listat pas ndryshimeve kushtetuese. Nuk e kam të qartë pse e ka lënë pa një numër tavan këtë dispozitën e numrit të listës. Këto normalisht kanë qenë të mirëmenduara patjetër që ndryshon dhe formula zgjedhore, ndryshon dhe fleta e votimit dhe kjo e bën të pa qartë sepse përdoret pjesa “nuk mund të jetë më i vogël se dhe nuk ka një pjesë që mund të jetë më i madh se”. Pra, pa dashur të parashikojë ligjvënësin që e ka lënë dispozitën të hapur dhe pse i ndërjegjshëm që po bënte lista të hapura dhe ku fleta e votimit do të kishte patjetër dhe kandidatët qofshin këta me numra apo emra duket si diçka e qëllimshme pse është lënë lista e tillë. Pastaj debati tjetër nëqoftëse jemi në kushtet e barazisë apo pabarazisë nëqoftëse një parti paraqet më shumë emra dhe numra sesa një parti tjetër. Kjo është një çështje që duhet ta kishte zgjidhur ligjvënësi, nuk e ka zgjidhur e ka pasur gjithë mundësinë për ta zgjidhur dhe ndoshta zoti Salianji si përfaqësues i Partisë Socialiste që ka qenë dhe nismëtare e ndryshimeve, ndoshta mund të na japë një interpretim të tijin pse pika 4 ka mbetur po njësoj, përveç pjesës së kuotës gjinore që pretendohet të

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

respektohet nëpërmjet kësaj dispozite. Pse nuk ka vendosur një numër tavan në lidhje me numrin që do kishin listat në çdo qark brenda mundësive nëqoftëse e ka informacionin?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Për respekt të pyetjes që thashë është në vullnetin e një ligjvënësi, sepse ata e kanë miratuar dhe shkruar në këtë mënyrë. Por do të thoja, prandaj vullneti i ligjvënësit lexohet në të gjithë dispozitat, prandaj jemi ne këtu dhe ju si institucion të bëni interpretimin e ligjit duke u referuar në gjithë dispozitat, prandaj ka një Komisioner, ka dhe Rregullator, prandaj jeni dhe ju këtu. Prandaj janë dhe këto institucione zgjedhore ku dispozitat të cilat miratohen nga ligjvënësit të interpretohen në mirëbërjen e zgjedhjeve se Kodi Shqiptar është Kodi me më shumë nene që mund të jetë besoj në rajon dhe shtu ujë e shtu miell është bërë Kodi Zgjedhor për çdo rast që del, del nga një teori e re. Këtu ka një institucion që është KQZ-ja, prandaj unë i referohem se ka një traditë të bërjes së zgjedhjeve dhe kjo kur interpretohet dhe me aktet e KQZ-së dhe urdhëresat dhe mënyrës se si Komisioneri parashikon t'i organizojë zgjedhjet. Pra nuk është gjetur rrugëve fleta e votimit, është gjëja më e rëndësishme e këtij procesi, prandaj ne të gjithë kemi të bëjmë më një proces parazgjedhor pse të organizohemi vetëm 1 ditë. Pra, gjithë ky proces që organizohet sot vetëm për një ditë dhe ju jeni organet qendrore të cilët nuk merrni vendimmarrje vetëm për sot por merrni vendimmarrje duke pasur parasysh se si do të zhvillohet data 25 prill dhe data 25 nqs i referohesh të gjithë dispozitave të Kodit Zgjedhor, urdhëresave besoj si dhe mos cënimi i të drejtave, se në rastin konkret nëqoftëse do ishim, pra ka të bëjë cili është cënimi që i bëhet Partisë Demokratike. Është kjo e drejtë në përputhje me gjithë garuesit e tjerë? Është inferiore lista e partisë përse i përket numrit në krahasim me numrin për listat e miratuara? Në datën 25 prill është i

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

njëjtë numri i kandidatëve është i njëjtë me gjithë subjektet e tjera. Pra ligjvënësi në momentin që e ka miratuar “shtohet 2” ka pasur në mendje kuotën gjinore. Tani na doli një problem tjetër që unë e gjeta këtë mosshqyrtim të vijës maksimale dhe unë do ta përdor që të sjellë sa më shumë! Jo, prandaj jeni ju këtu që ti vini ju rregullat, ju të gjithë partive t’i thoni që keni këto të drejta dhe në bazë të këtyre rregullave do garoni. Se në fund të fundit këto janë rregulla për garën, kaq!

**Z. K. Bele:** Faleminderit zoti zëvendës, nuk e kam kuptuar pse nuk ka një akt rregullator për këtë. A është çështje se është e planifikuar dhe s’ka ndodhur apo e keni kuptuar që është e qartë dispozita ose më saktë ta riformuloj pyetjen. Është në planet afatshkurtra, afatmesme, akt rregullator pra është nga ato dispozita që s’ka bazë siç thotë parashikuesi?

**Z. Y. Merkaj:** Nuk është parashikuar në aktet që të futet në kompetencën e rregullatorit kështu që s’ka pasur.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Pra legjislatori, përveç se ka shkruar dispozitën si e ka shkruar po paska harruar dhe ti japë mundësinë.

**Z. I. Rusmali:** Për zotin Salianji e kam, ankuesi në parimet e veta të parashtrojë ndër të tjera argument pro pozicionit të vet dhe që ankuesi garon në këto zgjedhje si koalicioni dhe interesat legjitime të koalicionit t’ia imponojë një listë të gjatë. Ju garoni si parti politike. Ky dallim, dallimi midis faktit që ju jeni koalicion dhe ata janë parti i justifikon pretendimet e ankuesit apo pavarësisht se ju jeni parti e ata koalicion trajtimi duhet të jetë i barabartë?

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Në fakt, këtë pyetje e diskutuam në seancë. Jemi të qartë pse kjo lista tej numrit ligjor ka një shkak pse vjen dhe shkak është koalicioni që është i Partisë Demokratike, por sherrin nuk mundet ta transferojë në KQZ. Koalicioni ndërtohet në bazë të rregullave dhe ato rregulla partitë e koalicioni janë të detyruar ti zbatojnë. Nuk janë marr vesh se si do garojnë e ku do garojnë dhe këtë debat e sjellin tek ju besoj se përderisa nuk e kanë zgjidhur vet koalicioni nuk besoj se mund ta zgjidhni ju sherrin që ka Partia Demokratike me partitë aleate. Për sa i përket emrave se po të kishte vullnet ka mundësi për ta zgjidhur bilës unë e lexoj në të kundërt që i humbet të drejtën partive që ti i ke vënë afër listës poshtë vijës së kuqe, të cilët mund të jenë parti koalicioni të cilët mund të kapin hersin. Pra i gënjen "aleatët", pra çon një listë më të madhe dhe thua shiko merr votat se do kalosh listën fituese .

**Z. L. Braho:** Zoti Salianji, nuk besoj që ka vend debati aq më tepër nga ju si subjekt i interesuar. Ju s'jeni koalicion, jeni subjekt kështu që subjekti mbrohet vet, nuk ka vend për sherr.

**Z. E. Lako:** Ka ndonjë pyetje? Dakord, shkurtimisht kam edhe unë 3 pyetje për subjektin ankues. Pyetja e parë ka të bëjë me faktin se Komisioneri ka mbajtur të njëjtin qëndrim përse i përket listave të kandidatëve nga të gjithë subjektet zgjedhor në dy vendimmarrje të tij, qoftë me vendimin nr.131, qoftë me vendimin nr.156. Pyetja konsiston pse subjekti juaj nuk ka bërë ankim që me vendimin e parë? Pra kur i është kërkuar që të sjellë numrin që ka publikuar dhe kërkuar gjithë subjekteve? Pyetja e dytë ka të bëjë që ju si subjekt zgjedhor për palën e interesuar janë subjekte që mund të sjellin një listë shumë më të madhe dhe se kjo që është paraqitur. Ju mendoni nga interpretimi që i bëni ligjit ky numër është infinit, është

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

pa limit numrit tavan? Pyetja e tretë ka të bëjë me faktin që ju e përmendët tek pretendimet që kjo bëhet për përfaqësim më dinjitoz përfaqësim i gjithë koalicionit pyetja që kam unë është që në çdo zonë zgjedhore është mbajtur ky qendrim. Pra, lista e subjekteve që ka ardhur në KQZ përfaqëson gjithë koalicionin në çdo zonë zgjedhore, faleminderit.

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Faleminderit, shpresoj që ti mbaj mend të treja që të përgjigjem. Pse nuk është ankimuar vendimi nr.131? Vendimi nr.131 në dispozitivin e vet kthente lista për plotësim dhe në thelb listat kishin nevojë siç kishin nevojë listat e gjithë subjekteve të tjera për plotësime dhe korrigjime të cilat u kryen edhe ajo pikë e arsytimit të Komisionerit për sa i përket numrit të lejuar u prek pavarësisht se jo ashtu siç do të donte Komisioneri. Pra dhe aty u shtuan, u prek në përputhje me dispozitën dhe leximin që ne i bëjmë dhe për të mos e kthyer në një ping pong që çfarë tha Komisioneri, çfarë i çojmë ne e plotësojmë apo nuk e plotësojmë. Në momentin që e kemi riparqitur listat me të gjitha momentet e ngritura në vendimmarrjen nr.131 të prekura dhe të plotësuara ashtu si ne dimë dhe lexojmë ligjin dhe për këtë pikë kemi paraqitur arsyetimin tonë. Nëqoftëse shikoni praktikat dokumentare listat janë shoqëruar me një shkresë të gjatë shpjeguese se përse është prekur numri i lejuar duke e çuar në 222 dhe cila është arsyeja ligjore mbas këtij veprimi. Për sa na përket, vendimi ka ezauruar efektet dhe të gjithë pikat që ajo vendimmarrje prek në dispozitivin e saj po se po dhe në pjesën arsyetuese të saj janë prekur dhe reflektuar nga ana jonë në momentin që ne kemi kthyer përgjigje dhe kemi ridepozituar listat. Për sa na përket është ezauruar ajo pjesë. E dyta që ju thatë është fakti: A është pa limit? Duke bërë arsyetimin literalisht kur themi fjalën nuk ka një tavan, do të thotë idealisht nuk ka një limit sipëror pra objektivisht duke interpretuar këtë pikë ishte pyetja që bëri zoti

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

Rusmali, se ku qëndron përgjegjësia e një subjekti politik e harmonizuar kjo me nevojat e veta politike për përfaqësime harmonizuar kjo me nevojat qoftë të subjekteve zgjedhore, qoftë të institucioneve që rregullojnë procesin zgjedhor për të patur një proces zgjedhor të menaxhueshëm jo vetëm nga pikëpamja e paraqitjes së listës por edhe e paraqitjes së tyre në fletën e votimit e më pas në procesin e numërimit e më pas në procesin e nxjerrjes së rezultatit. Pra limiti ashtu siç e ka parashikuar legjislatori qëndron tek përgjegjësia dhe përgjegjshmëria e një subjekti politik i cili paraqet një listë kandidaturash në listat e veta shumemërore të përputhëshme me nevojat e veta subjektive duke respektuar kriteret ligjore. Pra, duke patur një numër të plotpjesëtueshëm me 3 dhe duke patur përgjegjësi që i paraqitet elektoratit dhe jo vetëm institucioneve që menaxhojnë procesin me një listë kandidaturash, jo vetëm që plotësojnë kriteret ligjore por dhe të besueshme sepse është ekzigjencë edhe politike që kur paraqet listën e kandidaturave të mos paraqitësh një listë të pafundme. Ç'ka do t'i relativizonte kandidaturat por për të paraqitur një minimum në mënyrë që lista të jetë serioze. Të gjithë subjektet të jenë paraqitur, kriteret e ligjit të jenë respektuar por dhe institucioni nga ana tjetër ta ketë të lehtë që të menaxhojë procesin zgjedhor. Pra besojmë se kështu e ka logjikuar dhe legjislatori kur e ka lënë në këtë formë dispozitën. Pyetja e tretë a e kemi reflektuar në çdo zonë zgjedhore?

**Z. E. Lako:** A janë të gjitha partitë në koalicion pjesëmarrëse?

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Atëherë, ajo ç'ka unë kisha pretenduar në ankim dhe e thashë është që subjekti zgjedhor aq më tepër kur është koalicion duhet ta ketë këtë të drejtë që të gjithë subjektet që kërkojnë të përfaqësohen në zona zgjedhore të caktuara me të paktën një kandidaturë të kenë mundësi ta bëjnë këtë

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

gjë. Në pjesën më të madhe e kemi bërë, por ka dhe raste që nuk e kemi bërë që sigurisht si çdo ekuacion qoftë brenda një partie si dhe një koalicioni vendosen në barazpeshë shumë interesa dhe shumë vlera qofshin këto dhe vlera të vetë kandidatëve. Kjo sepse, flukse të ndryshme sjellin në një garë të brendëshme më përpara dhe më pas një garë me kundërshtarin politik. Aty ku nuk ka ndodhur kjo, ka qenë e pamundur për logjika të maksimalizimit të votës. Pra, logjika të brendëshme të koalicionit por ne qendrojmë për faktin ku kjo e drejtë duhet të jetë e pakushtëzuar në kuptimin që nëqoftëse koalicioni do t'a ushtrojë këtë të drejtë të ketë mundësinë t'a ushtrojë dhe nëqoftëse nuk e ushtron të varet nga ai dhe jo nga faktorë të tjerë të jashtëm.

**Z. E. Lako:** Faleminderit, zoti Kaso. Nëse nuk kemi më pyetje për tu drejtuar palëve, unë besoj se një kopje të atyre çfarë ju parashtruat e keni me shkrim dhe duhet ta dorëzoni tek administrata.

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Ne kemi ankimin i nderuar nuk kemi sjellë parashtrime, pjesa tjetër është shtjellim pse janë shkruar gjërat në atë formë.

**Z. E. Lako:** Shkurtimisht pala ankuese si fillim, çfarë pretendoni dhe çfarë kërkoni nga KAS-i?

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Kërkoj nga KAS-i pranimin e ankimit, ndryshimin e vendimit nr.156 të Komisionerit duke regjistruar listat e subjektit zgjedhor Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim në formën si e ka paraqitur subjekti zgjedhor, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. E. Lako:** Faleminderit edhe pala e interesuar?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Kërkojmë lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit për miratimin e listave të Partisë Demokratike.

**Z. E. Lako:** Atëherë, ne do të tërhiqemi për vendim. Ju lutem të na falni, jemi të kondicionuar dhe nga një çështje që është mbrapa kësaj. Besoj për 30 minuta do t'ju thërrasim. Nëse do të ketë ndonjë debat do t'ju njoftojmë për çdo rast, faleminderit!

**Rifillon mbledhja**

**Ora 13:15**

**Z. E. Lako:** Atëherë, KAS në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.156 datë 17.03.2018, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara me shumicë votash, mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1, nenit 30 të vendimit nr.3 datë 6.11.2020 të Komisionit Rregullator vendosi:

1. Pranimin e kërkesës ankimore nr.5 datë 19.03.2021 të subjektit zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim;
2. Ndryshimin e vendimit nr.156 datë 17.11.2021 të KQZ-së “Për shqyrtimin e kërkesës së listave shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.
3. Regjistrimin e listave shumemërore të subjektit zgjedhor Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, sipas listës së depozituar në datën 16.03.2021 pranë KQZ-së;

**Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino**





**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021**

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së;
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

Vendimi i arsyetuar dhe i plotë do t'ju jepet sa më shpejt sapo të zbardhet, faleminderit!

**Vendimi nr.9**

**Zbardhi materialin audio  
Silvi Sino**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**23.03.2021**  
**Ora 13:20**

**RENDI I DITËS**

**Projektakti "Për relativimin e kërkesës ankimore nr.6, kundërshtim i vendimit nr.165 dt.18.03.2021, subjekti ankues ALEANCA-AL".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**
- **Koalicioni:** Aleanca-Al

**Z. E. Çefa:** Mirëdita të gjithëve, po hapim sot seancën publike të KAS, në KQZ për vlerësimin paraprak të kërkesës ankimore me nr.6, të subjektit politik Koalicioni Aleanca-AL, kundër vendimit nr.165, datë 18 mars 2021 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Relatori i kësaj çështje sipas shortit të hedhur me datë 20 mars 2021, jam unë, Elvis Çefa, të pranishëm në seancë janë të gjithë anëtarët e Komisionit! Përpara se tja jap fjalën Sekretarit të Përgjithshëm për të na bërë një përmbledhje të shkurtër të ankimit, dëshiroj të pasqyrojmë edhe prezencën e subjektit ankues apo jo?

**Z. Eduard Abazi:** Unë jam kryetari i subjektit Aleanca-AL, njëherësh dhe i Partisë Aleanca Demokratike që është partia udhëheqëse e koalicionit.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit, subjekte të tjera të interesuara? Nuk ka!?

**Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. E. Abazi:** Jo, unë do të përfaqësoj vetëm dhe përfaqësuesi jonë ligjor, kemi dhe avokatin Erjon Syziu!

**Z. E. Çefa:** Faleminderit, besoj autorizimet i depozitoni pak më vonë tek administrata. Atëherë, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ, shkurtimisht ju lutem përmbajten e ankimit!

**Z. Y. Merkaç:** Atëherë, Koalicioni Aleanca është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet, për kohën e datës 25 prill 2021 dhe ka depozituar pranë KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.138, të datës 11.03.2021, ka vendosur kthimin për korigjim dokumentacioni të listës shumëmemërore. Brenda afatit ligjor Koalicionit Aleanca-AL ka depozituar dokumentacionin e korigjuara dhe gjatë verifikimit të dokumentacionit të korigjuar të paraqitur nga Koalicioni Aleanca, është verifikuar se nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 67, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor. Kështu Koalicioni Aleanca-AL, nuk ka paraqitur dokumentacionin provues për plotësimin e kërkesave të nenit 68 të Kodit Zgjedhor. Koalicioni ka paraqitur vërtetim për zotërimin e 2 mandateve në Kuvend, në një kohë që pjestari i Koalicionit Aleanca-AL janë 5 parti politike. Partitë pjesmarrëse në Koalicion nuk vërtetojnë se zotërojnë bashkarisht në Kuvend numër mandatesh jo më të vogël se numëri i pjestarëve të koalicionit, gjithashtu nuk janë paraqitur as listat mbështetëse jo më pak se 7000 zgjedhës në shkallë Kombëtare. Në këto kushte duke qenë se nuk plotësojnë kërkesat e nenit 68, pasi nuk plotësojnë numrin e mandateve që zotëron koalicioni. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka refuzuar listat shumëmemërore të Koalicionit Aleanca-AL, për zgjedhjen për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

2021. Ndaj vendimit nr. 165 datë 18 mars 2021 kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Koalicioni Aleanca-AL duke kundërshtuar duke thënë me pretendimin se fillimisht Koalicioni Aleanca -Al kanë qenë 7 parti pjesëmarrëse në koalicion, 5 parti prej tyre të pjestarëve të koalicionit nuk kanë paraqitur kandidatë dhe nënkuptohet që janë tërhequr nga gara, kështu që mbeten 2 parti. Për 2 parti ky koalicion nuk plotëson mandatet dhe ky është arsyetimi i bërë nga Kolaicioni Aleanca-Al në ankimin e paraqitur pranë KAS-it, faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Po falemindrit, ndonjë kërkesë procedurale paraprake për këtë fazë vetem për këtë fazë të shqyrtimit?! Jo, për themelin!

**Z. E. Syziu (avokati i Koalicionit Aleanca-AL):** Zoti kryetar, me leje? Në lidhje më çfarë relatoi Sekretari i Përgjithshëm, jemi përgjithësisht dakort! Me rezerva, që për efekt se koha në dispozicion ka qenë e shkurtër për të bërë një ankim sa më të plotë kemi bërë një plotësim në ankimin që jemi drejtuar KAS-it dhe kërkojmë që kjo shtesë në këtë ankimim të jetë në konsideratë nga ana juaj. Një kopje ta vendosim në dispozicion pasi kemi cituar në të rrethana shumë më të gjëra dhe duke i veshur edhe përputhshërinë ligjore të kërkesave tona të paraqitura në kërkesën ankimore si dhe gjithashtu rezervojmë të drejtën që KAS ti vendosi në dispozicion dy shkresa, dy prova, të cilat gjithashtu vërtetojnë qëndrimin e subjektit politik Aleanca, koalicionit që në thelb ky koalicion ka aktualisht në përbërjen e tij jo 7 parti politike por 2 parti politike.

**Z. L. Braho:** Më fal, në lidhje me palët që janë se po shoh marveshjen që është depozituar në KQZ, kur është regjistruar koalicioni përcaktohet që përfaqësues ligjor



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

i subjektit zgjedhor Aleanca pranë KQZ-së do të jëtë zoti Besnik Spahiu dhe zoti Dritan Mullahaj, pra sot kush është një nga këto personat këtu?

**Z. D. Mullahaj:** Unë jam Dritan Mullahaj, një nga kordinatorët e Koalicionit Aleanca në KQZ, kam qenë dhe tek mbledhja e mëparshme e KQZ-së.

**Z. L. Braho:** Po palët e tjera? Dy personat e tjerë kanë ndonjë autorizim për sot?

**Z. Eduard. Abazi:** Unë jam kryetari i koalicionit i partisë drejtuese të koalicionit, Eduard Abazi njëherësh dhe i Aleancës Demokratike dhe zoti Syziu është Avokati për të mbështetur propozimet tona.

**Z. L. Braho:** Unë nuk e vë në diskutim atë, po marrveshjen që keni depozituar në KQZ kur keni regjistruar koalicionin keni përcaktuar që përfaqësues ligjorë do të jenë Besnik Spahiu dhe Dritan Mullahaj. Kështu që se di administrata e KQZ-së nëqoftëse mund të na bejë ndonjë sqarim në lidhje me këtë pjesë. Nëqoftëse marrveshja është aneks i vendimmarrjes të Komisionerit për regjistrimin e Koalicionit.

**Z. E. Çefa:** Atëherë avokati përfaqëson këtu me deklaram, deklaroj zotëria këtu para nesh kështu që nuk ka nevojë për autorizim për avokatin në mënyrë të shprehur sepse vetë firmtari i ankimit deklaron para institucionit konsiderohet e mirqenë. Për sa i përket ankimit avokat ju lutem sqaroni dhe diçka! Ju keni bërë ankim shtesë sot apo thjeshtë keni plotësuar ankimin e mëparshëm? Pra keni ngritur element të tjerë që si kishit ngritur në ankimin e parë apo jo?

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

**Z. E. Syziu (avokati i Koalicionit Aleanca-AL):** Kemi bërë një plotësim në ankim nuk kemi bërë akim të ri. Thjeshtë elementët e rinj që ne sjellim në ankim i kemi lidhur me përputhshmërinë ligjore të atyre fakteve dhe rrethanave që ne mendojmë që shkojnë në funksion të pranimit të kërkesës tonë.


**Z. E. Çefa:** Dakord, faleminderit. Gjithsesi do i përkasi dhe gjykimit në themel pastaj dhe vlerësimi i provave të tjera. Atëherë bazuar në Kodin Zgjedhor në rregulloren e funksionimit të KAS-it në cilësinë e relatorit të kërkesës ankimore të regjistruar me nr.06 me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr.165 18 mars 2021, me ankues Koalicioni i Aleanca- AL. Pasi vlerësova paraprakisht kriteret e përcaktuara në nenin 130 të Kodit Zgjedhor, vërej se: Nga pikëpamja formale, ankimi i subjektit të mësipërm i cili është regjistruar në KQZ në datën 20.03.2021 rezulton të ketë respektuar kërkesat e nenit 10, të Rregullores së KAS-it për sa i përket elementit të formës dhe të përmbajtjes dhe në këtë këndvështrim rezulton të jetë i plotë dhe pa të meta.

1. Së pari KAS, ka kompetencë lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e ankimit në fjalë, në këndvështrim të nenit 12, të Kodit Zgjedhor, neni 16 të Kodit Zgjedhor, neni 21 dhe paragrafi i dytë i nenit 124 dhe 1 i Kodit Zgjedhor.

2. Së dyti për sa i përket legjitimitetit të ankimuesit referuar nenit 123 paragrafi i parë i Kodit Zgjedhor, ankimuesi legjitimohet në këtë kërkim dhe në këtë kontekst edhe Koalicioni Aleanca i cili ka paraqitur këtë ankim, provohet se ka një interes të ligjshëm në këtë vendimmarrje. Për këtë arsye ai legjitimohet për paraqitjen e këtij ankimi përpara KAS-it.

3. Së treti lidhur me respektimin e afateve ligjore për ankimin, flasim gjithmonë për ankimin e depozituar fillimisht. Referuar paragrafit 2 të nenit 24/1 të Kodit Zgjedhor

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.23.03.2021*

është respektur afati 3 ditor nga marrja e vendimit dhe në këtë kontekst, ankimi i paraqitur konsiderohet në afat në konformitet sipas nenit 124/1 të Kodit Zgjedhor. Si përfundim sipas verifikimit paraprak të parashtruar më sipër, në cilësinë e Relatorit bazuar në nenet 129, 130, 131 të Kodit Zgjedhor propozoj:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore në fjale.
2. Zhvillimin e seancës për shqyrtimin e ankimit në themel, ditën e nesërme datë 24 mars, ora 13:30 nëse dhe për ju është mirë?

Jemi dakord me datën, me orën? Në rregull, faleminderit. Atëherë seanca deklarohet e mbyllur.

**Vendimi nr.10**

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*

